



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.107**

**9 gusht**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 454 datë 21.7.2011	Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë.....	4251
Ligj nr.10 455 datë 21.7.2011	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.....	4264
Ligj nr.10 456 datë 21.7.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar.....	4265
Ligj nr.10 457 datë 21.7.2011	Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.....	4268
Ligj nr.10 458 datë 21.7.2011	Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.....	4269
Ligj nr.10 459 datë 21.7.2011	Për disa ndryshime në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar.....	4272
Vendim i GJK nr.32, datë 22.7.2011	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.426, datë 18.11.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	4275
Vendim i GJK nr.33, datë 22.7.2011	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.311, datë 12.3.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; të vendimit nr.14, datë 20.3.2008 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe të vendimit nr.61, datë 26.12.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda	4278
Vendim i GJK nr.34, datë 25.7.2011	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr.751, datë 10.4.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimi i çështjes për rigjykim.....	4284

**LIGJ**  
**Nr.10 454, datë 21.7.2011**

**PËR TRANSPLANTIMIN E INDEVE, TË QELIZAVE DHE TË ORGANEVE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Qëllimi i ligjit**

Ky ligj ka për qëllim të garantojë respektimin e standardeve të cilësisë dhe të sigurisë gjatë kryerjes së veprimtarisë së transplantimit të indeve, qelizave dhe organeve me origjinë njerëzore, të realizuara në Republikën e Shqipërisë, për ruajtjen e shëndetit publik.

Neni 2  
**Objekti**

Ky ligj përcakton:

- a) shërbimet themelore të përfshira në veprimtarinë e transplantimit të indeve, qelizave dhe organeve;
- b) organizimin, funksionimin, inspektimin, licencimin dhe akreditimin e strukturave shëndetësore, të përfshira në veprimtarinë e transplantimit të indeve, qelizave dhe organeve;
- c) programimin dhe bashkërendimin e punës në këtë fushë;
- ç) normat e cilësisë dhe të sigurisë për indet, qelizat dhe organet njerëzore.

Neni 3  
**Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet në të gjitha strukturat shëndetësore që ushtrojnë veprimtari në fushën e transplantimit të organeve, indeve dhe qelizave, sipas legjislationit në fuqi.

2. Ky ligj zbatohet për të gjitha transplantimet që kryhen:

- a) brenda të njëjtit individ nga një pjesë e trupit te një tjetër;
- b) midis individëve që kanë lidhje gjaku (gjyshi, gjyshja, prindi, fëmija, tezja, daja, xhaxhai, halla, nipi, mbesa), me përjashtim të qelizave riprodhuese;
- c) midis individëve që nuk kanë lidhje gjaku (vjehrra, vjehrra, bashkëshorti, bashkëshortja), sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj;
- ç) për indet dhe qelizat, përfshirë qelizat gjakformuese nga gjaku periferik, për kordonin umbilikal (gjaku) dhe qelizat nga palca e kockave, për qelizat riprodhuese (vezët, sperma), indet dhe qelizat fetale.

---

<sup>1</sup> Ky projektligj është përafshuar pjesërisht me:

Direktivën 2004/23/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 31 mars 2004 "Mbi vendosjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë për dhurimin, prokurimin, testimin, përpunimin, magazinimin dhe shpërndarjen e indeve dhe qelizave njerëzore". Numri CELEX: 32004L0023, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 102, datë 7.4.2004, faqe 48-58.

## Neni 4 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Dhurim” është procedura e dhurimit të indeve, qelizave dhe organeve njerëzore, të menduara për aplikime njerëzore.
2. “Dhurues” është një person, i gjallë ose i vdekur, nga i cili është realizuar heqja e indeve, qelizave apo organit për t'u implantuar te një individ i cili ka nevojë për të.
3. “Gonade” janë gjendrat kryesore seksuale (vezoret dhe herdhet), ku formohen dhe zhvillohen qelizat seksuale (vezët dhe spermatozoidet).
4. “Gjurmim” është tërësia e proceseve që ndiqen për të identifikuar indin, qelizën, organin gjatë çdo hapi, duke filluar nga përzgjedhja, përpunimi, testimi, ruajtja deri në shpërndarjen pranë përfituesit apo deri në asgjësim të tyre.
5. “Inde” janë të gjitha pjesët përbërëse të trupit të njeriut, të formuar nga qelizat, të lidhura me ind lidhës ndërmjet tyre.
6. “Konservim” është përdorimi i agjentëve kimikë, ndryshimi i kushteve të mjedisit apo faktorëve të tjerë gjatë procesit të përpunimit, për të parandaluar apo shtyrë afatin kohor të shkatërrimit biologjik ose fizik të transplanteve.
7. “Menaxhim i cilësisë” është veprimtaria e koordinuar për të drejtuar dhe kontrolluar një subjekt në lidhje me cilësinë.
8. “Organ” është një pjesë e diferencuar dhe vitale e trupit të njeriut, e formuar nga inde të ndryshme, që ruan strukturën, vaskularizimin dhe kapacitetin për të zhvilluar funksione fiziologjike me një nivel të rëndësishëm pavarësie, i plotë ose një pjesë e tij.
9. “Pacient në pritje” është një person i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Personave në pritje për realizimin e implantimit të transplantit.
10. “Përfitues” është një person, i cili ka përfutuar indin, qelizën apo organin nga procesi i transplantimit.
11. “Përpunim” është procedura e përgatitjes, trajtimit dhe paketimit të indeve, qelizave dhe organeve të menduara për transplantim.
12. “Qelizë” është qeliza individuale e njeriut ose një grup qelizash të njeriut, kur nuk lidhen nga asnjë formë e indit lidhës.
13. “Qeliza riprodhuese” janë të gjitha indet dhe qelizat e synuara për t'u përdorur për qëllim të riprodhimit me teknika ndihmëse.
14. “Qeliza hemopoetike” janë qelizat “mëmë”, nga të cilat zhvillohen më tej qelizat e gjakut.
15. “Ruajtje” është mbajtja e transplanteve në kushte të përshtatshme, të kontrolluara deri në momentin e shpërndarjes së tyre.
16. “Vdekje” është humbja e pakthyeshme e funksionit të të gjithë trupit, përfshirë qelizat e tij.
17. “Transplantim” është procedura e heqjes dhe implantimit të indit, qelizës apo organit nga dhuruesi te përfituesi.
18. “Testim” është tërësia e ekzaminimeve laboratorike që kryhen transplanteve apo dhuruesit.
19. “Transplante” janë inde, qeliza, organe, që dhurohen nga një njeri dhe përdoren te një tjetër person, i cili ka nevojë për to.
20. “Shpërndarje” është transportimi dhe dorëzimi i indeve, qelizave dhe organeve që do të përdoren për implantim.
21. “Sistem i cilësisë” është struktura organizative, përgjegjësitë, procedurat, proceset dhe burimet e përcaktuara për zbatimin e menaxhimit të cilësisë dhe përfshin të gjitha veprimtaritë që kontribuojnë në cilësi, drejtpërdrejt ose tërthorazi.

## Neni 5

### **Parimet e transplantimit të indeve, qelizave dhe organeve**

Parimet e transplantimit të indeve, qelizave dhe organeve janë si më poshtë:

- a) heqja e indeve, qelizave dhe organeve për qëllime transplantimi kryhet vetëm për përfitime terapeutike të përfituesit;
- b) transplantimi i indeve, qelizave dhe organeve kryhet vetëm pasi përfituesi dhe dhuruesi ka dhënë pëlqimin e lirë.
- c) dhurimi i indeve, qelizave dhe organeve bazohet në dhurimin vullnetar dhe të papaguar, duke ruajtur anonimat, si të dhuruesit, ashtu dhe të përfituesit, altruizmin e dhuruesit dhe solidaritetin midis dhuruesit dhe përfituesit, dhe në respektim të jetës dhe të shëndetit të dhuruesit.

## Neni 6

### **Ndalimet**

1. Ndalohet transplantimi i indeve, qelizave dhe organeve për përfitime financiare.
2. Ndalohet transplantimi i trurit dhe gonadeve.
3. Ndalohet manipulimi gjenetik i embrionit, qoftë dhe për qëllime transplantimi.
4. Ndalohet dhurimi i organeve nga dhurues të mitur, të gjallë.
5. Heqja e indit, qelizave apo organit nuk mund të kryhet ndaj një personi të paaftë për të dhënë pëlqimin, me përjashtim të përcaktimeve të nenit 20 të këtij ligji.
6. Ndalohen promovimi dhe reklamimi me qëllim kërkese apo oferte të organeve.

## KREU II

### **ORGANIZIMI I STRUKTURAVE SHËNDETËSORE TË TRANSPLANTIMEVE**

## Neni 7

### **Veprimtaritë gjatë kryerjes së transplantimit**

1. Veprimtaritë, që kryhen gjatë procesit të transplantimit të indeve, qelizave dhe organeve janë:
- a) promovimi i dhurimit vullnetar dhe të papaguar;
  - b) procesi i dhurimit të transplanteve;
  - c) përzgjedhja dhe seleksionimi i dhuruesve;
  - ç) procedura e testimit;
  - d) procedura e përpunimit të transplanteve;
  - dh) procedura e konservimit dhe ruajtjes së transplanteve;
  - e) procedura e shpërndarjes së transplanteve;
  - ë) kryerja e transplantimit;
  - f) procedura e sigurimit të cilësisë.
2. Veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni lejohen të kryhen vetëm në strukturat shëndetësore spitalore të specializuara për shërbimin e transplantimeve, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi.
3. Rregulloret e funksionimit të veprimtarive të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni miratohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

## Neni 8

### **Strukturat shëndetësore të shërbimit të transplantimeve**

Strukturat shëndetësore të shërbimit të transplantimeve janë:

- a) bankat e indeve, qelizave dhe organeve;
- b) Qendra për Koordinimin e Transplantimeve;
- c) qendra e kryerjes së transplantimit.

## Neni 9

### Bankat e indeve, qelizave dhe organeve

1. Bankat e indeve, qelizave dhe organeve janë struktura shëndetësore që kryejnë veprimtaritë e mëposhtme:

a) përzgjedhjen, vlerësimin, testimin e indeve, qelizave dhe organeve;

b) ekzaminimin dhe përpunimin e tyre;

c) konservimin, ruajtjen, etiketimin dhe paketimin e indeve, qelizave e organeve dhe dokumentimin e të dhënave për to;

ç) shpërndarjen e indeve, qelizave dhe organeve të destinuara për transplantim.

2. Bankat e indeve, qelizave dhe organeve kanë për detyrë:

a) të bashkëpunojnë me departamentet e patologjisë, mjekësisë mjeko-ligjore, departamentet gjinekologjike-obstetrike të institucioneve të kujdesit shëndetësor, me bankat e gjakut dhe me qendrat e kujdesit shëndetësor që kryejnë implantimin dhe heqjen;

b) të mbajnë të dhëna për veprimtarinë e tyre, përfshirë llojin dhe sasinë e transplantëve të përzgjedhura, të testuara, të konservuara, të përpunuara, të ruajtura e të shpërndara institucioneve, që realizojnë transplantime, apo të hedhura, si dhe për origjinën e destinacionin e tyre, të menduara për aplikime njerëzore, sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloret përkatëse;

c) të kryejnë gjetjen (kërkimin) e dhuruesve pa lidhje gjaku të qelizave hemopoetike, ekzaminimin e tyre dhe ndërmjetësimin e transplantimeve të qelizave hemopoetike, të dhuruara nga dhurues pa lidhje gjaku;

ç) të mbajnë të dhëna për ekzaminimet e realizuara të dhuruesve të mundshëm të indeve, qelizave dhe organeve;

d) të mbajnë regjistrin e dhuruesve të mundshëm të qelizave hemopoetike;

dh) të sigurojnë, në bazë të kërkesës së institucionit të kujdesit shëndetësor, të dhëna për dhuruesit e mundshëm të qelizave hemopoetike nga këndvështrimi i vlerësimit të përshtatshmërisë së tyre për një përfitues të veçantë;

e) të sigurojnë dhe të koordinojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në shkëmbim të qelizave hemopoetike të menduara për transplant;

ë) të paraqesin në Ministrinë e Shëndetësisë një raport vjetor për veprimtarinë e tyre.

3. Kriteret për hapjen dhe mbylljen e bankave të indeve, qelizave dhe organeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## Neni 10

### Qendra për Koordinimin e Transplantimeve

1. Në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë krijohet Qendra për Koordinimin e Transplantimeve, për të organizuar dhe për të ndërmjetësuar procesin e transplantimit ndërmjet bankave dhe qendrave që kryejnë transplantim.

2. Qendra për Koordinimin e Transplantimeve kryen këto detyra:

a) mban Regjistrin Kombëtar të Personave që presin transplantimin e indeve, qelizave dhe organeve.

b) mban Regjistrin Kombëtar të Dhuruesve të Transplanteve.

c) mban Regjistrin Kombëtar të Transplantimeve të realizuara.

ç) bashkërendon ekipet e heqjes dhe implantimit të transplantit;

d) cakton përfituesit më të përshtatshëm për transplantet e hequra, bazuar në rezultatet e analizave të tipizimit lindor. Përzgjedhja e tyre realizohet vetëm nga Regjistri Kombëtar i Personave në pritje për transplantimin e indeve, qelizave dhe organeve;

dh) përpunon të dhëna të përgjithshme për heqjet, implantimet e realizuara dhe rezultatet e tyre për vitin pararendës dhe harton një raport që i paraqitet Ministrisë së Shëndetësisë deri më 31 mars të vitit pasues kalendarik;

e) bashkërendon metodologjikisht veprimtaritë e bankave për kërkim të dhuruesve të qelizave hemopoetike;

ë) siguron dhe bashkërendon bashkëpunimin ndërkombëtar në shkëmbimin e indeve, qelizave dhe organeve të menduara për transplantim.

3. Ministri i Shëndetësisë miraton me urdhër mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Qendrës për Koordinimin e Transplantimeve.

#### Neni 11

### **Qendra e kryerjes së transplantimit**

1. Qendrat, që kryejnë transplantimin, janë pjesë e shërbimit spitalor. Ato janë publike dhe private.

2. Qendrat publike të transplantimit ngrihen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, ndërsa ato private licencohen sipas legjislacionit në fuqi. Kriteret për hapjen dhe mbylljen e qendrave të transplantimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Qendrat e transplantimit realizojnë heqjen dhe implantimin e organeve, indeve dhe qelizave në bazë të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, në zbatim të tij.

4. Qendrat e transplantimit kryejnë këto detyra:

a) raportojnë për personat e regjistruar për transplantim pranë Qendrës për Koordinimin e Transplantimeve;

b) kryejnë implantimin vetëm për përfituesit e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Personave që presin për transplantimin e indeve, qelizave dhe organeve;

c) raportojnë për transplantimet e realizuara pranë Qendrës për Koordinimin e Transplantimeve;

ç) bashkëpunojnë me Qendrën për Koordinimin e Transplanteve për të caktuar përfituesit më të përshtatshëm të indeve, qelizave dhe organeve;

d) pas marrjes së të dhënave, sipas nenit 16 të këtij ligji, verifikojnë nëse janë plotësuar të gjitha kushtet që lidhen me heqjen e transplanteve;

dh) informojnë Qendrën për Koordinimin e Transplantimeve për dhuruesin e mundshëm;

e) sigurojnë të dhëna që kërkohen nga Qendra për Koordinimin e Transplantimeve lidhur me indet, qelizat, organet. Të dhënat e siguruarra e ruajnë anonimatit në mënyrë të tillë që, si dhuruesi, ashtu edhe përfituesi të mos identifikohen;

ë) dokumentojnë me shkrim përdorimin e indit, qelizave, organeve të hequra në protokollin, i cili i bashkëlidhet dokumenteve të tjera shoqëruese për transplantin e hequr. Ky protokoll përmban veçanërisht datën dhe vendin e heqjes, si dhe qëllimin përfundimtar të transplanteve të hequra. Në rast se ndërmerret një vendim që indet, qelizat dhe organet e hequra janë të papërshtatshme, arsyeja e mospërshtatshmërisë, si dhe mënyra e trajtimit të mëtejshëm të tyre shënohen në protokoll;

f) ruajnë të dhëna për heqjet dhe implantimet e realizuara dhe shënojnë të dhënat për organet e hequra në protokoll;

g) Dërgojnë protokollin pranë Qendrës për Koordinimin e Transplantimeve brenda 7 ditëve nga data e marrjes së një vendimi për qëllimin përfundimtar të transplanteve.

5. Qendrat, që realizojnë transplantimin e qelizave hemopoetike, plotësojnë detyrimet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni. Përveç kësaj, ato bashkëpunojnë me bankat e indeve dhe qelizave për kërkimin e dhuruesve të qelizave hemopoetike kur përzgjedhin dhuruesit e mundshëm, më të përshtatshëm që nuk kanë lidhje gjaku.

#### Neni 12

### **Etika mjekësore gjatë procesit të transplantimit**

1. Komiteti i Etikës Mjekësore trajton, sipas detyrimeve të këtij ligji, çështje të transplantimit të indeve, qelizave dhe organeve.

2. Komiteti i Etikës Mjekësore i jep institucionit shëndetësor miratimin ose refuzimin për sa i përket realizimit të heqjes së:

a) një organi në dobi të përfituesit, i cili nuk ka lidhje gjaku (bashkëshorti, bashkëshortja, vjehri, vjehrra) me dhuruesin;

b) indit rigjenerues nga i mituri ose personi i paaftë për të shprehur pëlqimin;

c) indet, qelizat në dobi të përfituesit, i cili nuk ka lidhje gjaku me dhuruesin.

3. Anëtarët e Komitetit të Etikës Mjekësore nuk duhet të jenë në konflikt interesi me pozicionin e tyre të punës. Ata nuk duhet të jenë pjesë e stafit mjekësor që merr pjesë në procesin e transplantimit.

4. Anëtarët e Komitetit të Etikës Mjekësore ruajnë konfidencialitetin e të gjitha të dhënave që kanë mësuar për sa i përket realizimit të veprimtarive të tyre. Përjashtim bëjnë rastet kur të dhënat bëhen të njohura me pëlqimin e dhuruesit, përfituesit ose një përfaqësuesi ligjor. Sigurimi i një pëlqimi apo refuzimi të tillë bëhet pjesë e të dhënave mjekësore të dhuruesit, të miturit, ose personit të paftë për të shprehur pëlqimin e tij/saj.

#### Neni 13

### **Krijimi i Komitetit Kombëtar të Transplantimeve**

1. Komiteti Kombëtar i Transplantimeve është organ këshillimor i Ministrisë të Shëndetësisë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të këtij komiteti miratohen me urdhër të Ministrisë të Shëndetësisë.

2. Komiteti Kombëtar i Transplantimeve këshillon Ministrinë e Shëndetësisë për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe për rishikime të rëndësishme ligjore, organizative e teknike në fushën e transplanteve.

#### KREU III

### **VLERËSIMI DHE SELEKSIONIMI I DHURUESVE**

#### Neni 14

### **Informimi i dhuruesve**

1. Mjeku, që vlerëson aftësinë shëndetësore të dhuruesit, e informon atë për qëllimin, natyrën dhe pasojat e dhurimit të transplantit dhe për rreziqet e mundshme që lidhen me to.

2. Kur dhuruesi është i mitur ose një person i paftë, të dhënat në fjalë i dërgohen përfaqësuesit të tij/saj ligjor. Informacioni që jepet duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm. Dhuruesi dhe përfaqësuesi ligjor i të miturit apo i personit të paftë gëzon të drejtën për të parashtruar pyetje për informacionin e marrë.

3. Dhuruesi dhe përfaqësuesi ligjor i të miturit ose i personit të paftë mund të kërkojë që një tjetër dëshmitar të jetë prezent kur janë duke marrë informacionin. Mjeku informon personat e lartpërmendur për këtë mundësi paraprakisht.

4. Të gjitha të dhënat, që mjeku përdor për të informuar dhuruesin, përshkruhen prej tij në një fletë informative, e cila më pas bëhet pjesë e dokumentacionit që mbahet për dhuruesin.

#### Neni 15

### **Dhënia e pëlqimit nga dhuruesit**

1. Dhurimi i transplanteve mund të kryhet vetëm pasi dhuruesi të ketë dhënë pëlqimin e lirë. Pëlqimi jepet me shkrim dhe ruhet në të dhënat mjekësore të dhuruesit.

2. Për rastet e heqjes së indit rigjenerues nga një i mitur ose person i paftë për të dhënë pëlqimin lidhur me dhurimin, dhurimi mund të kryhet vetëm me autorizimin e përfaqësuesit të tij/saj ligjor. Opinioni i të miturit merret në konsideratë si një faktor gjithnjë e më përcaktues në raport me moshën e tij/saj dhe shkallën e pjekurisë.

3. Dhuruesi ose përfaqësuesi ligjor i të miturit apo i personit të paaftë mund të tërheqin pëlqimin e tyre në çdo moment. Mjeku, që realizon heqjen, respekton një tërheqje të tillë, përveçse kur ekzistojnë procedura të pakthyeshme, ndërprerja e të cilave do të rrezikonte shëndetin dhe jetën e dhuruesit po të realizoheshin gjatë periudhës së heqjes.

#### Neni 16

### **Vlerësimi i gjendjes shëndetësore të dhuruesit, përzgjedhja dhe seleksionimi**

1. Qendra e transplantimit, që realizon heqjen, është përgjegjëse për vlerësimin e aftësisë shëndetësore të dhuruesit, me qëllim përcaktimin e aftësisë për të dhuruar transplante.

2. Para heqjes së një indii, qelize apo organi nga një dhurues, mjeku përkatës vlerëson:

a) gjendjen e tij/saj shëndetësore nëpërmjet kryerjes së ekzaminimeve apo procedurave mjekësore;

b) rreziqet e mundshme që kanë të bëjnë me dhurimin e transplantit kundrejt jetës apo shëndetit të dhuruesit;

c) procedurat e duhura, në mënyrë që të eliminohen, në të gjitha mënyrat e mundshme, rreziqet shëndetësore për jetën e dhuruesit, që lidhen me heqjen e transplantit, pa rrezikuar cilësinë dhe vitalitetin e transplantëve që hiqen.

3. Kriteret e përzgjedhjes së dhuruesve, testet laboratorike të detyrueshme që duhet të kryejnë para dhurimit të indeve, qelizave dhe organeve, si dhe afatet kohore përcaktohen me rregullore, të miratuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

4. Rezultatet e vlerësimit të dhuruesit dhe procedurat e testimit dokumentohen në dosjen personale të dhuruesit dhe çdo anomali raportohet sipas kërkesave të përcaktuara me rregullore të miratuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

5. Mjeku, që bën vlerësimin e gjendjes shëndetësore të dhuruesit, vendos nëse dhuruesi është i aftë ose jo për të dhuruar inde, qeliza apo organe. Të dhënat, që kanë të bëjnë me gjendjen shëndetësore të dhuruesit, nënshkruhen nga mjeku vlerësues dhe bëhen pjesë e dosjes personale me të dhënat mjekësore të dhuruesit.

6. Qendra e transplantimit, që ka realizuar heqjen, siguron dhe kujdesin e nevojshëm mjekësor ndaj dhuruesit për një periudhë afatgjatë pas heqjes së indit, qelizës apo organit.

#### Neni 17

### **Dokumentacioni për dhurimin e indeve, qelizave dhe organeve**

1. Çdo dhurues, përpara procesit të dhurimit të indeve, qelizave dhe organeve, nënshkruan një formular që lidhet me historinë e tij shëndetësore, të paraqitur nga strukturat përkatëse, dhe mban përgjegjësi personale. Formulari i nënshkruar nga dhuruesi nënshkruhet edhe nga mjeku që kryen vlerësimin e dhuruesit.

2. Të gjitha të dhënat e marra nga dhuruesit janë konfidenciale, përfshirë edhe rezultatet laboratorike.

3. Dokumentet për verifikimin e përshtatshmërisë së dhuruesve, për informacionin e marrë dhe dhënë dhuruesve e për mënyrën e dhurimit të indeve, qelizave e organeve, si dhe trajtimi i dhuruesve pas dhurimit përcaktohen në rregulloren përkatëse të miratuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

#### Neni 18

### **Trajtimi i dhuruesve**

1. Dhuruesit përfitojnë kompensim, i cili përfshin plotësimin e shpenzimeve dhe të vështirësive që lidhen me procesin e dhurimit.

2. Nëse dhuruesi vlerësohet i papërshtatshëm për të dhuruar, atij i njihet e drejta për t'u kompensuar për kohën e harxhuar për këtë qëllim.



3. Vlera e kompensimit për rastet e përmendura më lart bëhet kundrejt vërtetimit zyrtar të strukturës përkatëse. Masa dhe mënyra e dhënies së kompensimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## KREU IV HEQJA DHE TRANSPLANTI

### SEKSIONI I HEQJA E INDIT APO ORGANIT NGA PERSONA QË JETOJNË

#### Neni 19

#### **Realizimi i heqjes së indeve, qelizave dhe organeve në dhurues të gjallë**

1. Heqja e indeve, qelizave dhe organeve nga një dhurues mund të realizohet vetëm, nëse:
- a) kryhet vetëm për përfitime mjekësore të përfituesit;
  - b) nuk ekziston, në momentin e heqjes, asnjë metodë tjetër terapeutike me efektshmëri të krahasueshme;
  - c) dhuruesi ose përfaqësuesi i tij/saj ligjor kanë dhënë pëlqimin, sipas nenit 15 të këtij ligji;
  - ç) indet janë rigjeneruese ose organi i përket një prej çiftit të organeve që funksionojnë;
  - d) heqja e indeve, qelizave dhe organeve nga një dhurues mund të realizohet për përfitime mjekësore të përfituesit, i cili është një person që ka lidhje gjaku (gjyshi, gjyshja, prindi, fëmija, tezja, daja, xhaxhai, halla, nipi, mbesa) me dhuruesin, atëherë kur dhuruesi ka dhënë pëlqimin e tij/saj për përfituesin në fjalë;
  - dh) heqja e organeve nga një dhurues mund të realizohet për përfitime mjekësore të përfituesit, i cili është një person që nuk ka lidhje gjaku (vjehri, vjehra, bashkëshorti, bashkëshortja) me dhuruesin, vetëm me kusht që:
    - i) dhuruesi të deklarojë me shkrim në mënyrë të qartë dëshirën për t'i dhuruar përfituesit organin e tij/saj;
    - ii) dhurimi në fjalë të jetë miratuar nga Komiteti i Etikës Mjekësore;
  - e) heqja e indeve dhe qelizave nga një dhurues mund të realizohet për përfitime mjekësore të përfituesit, i cili është një person që nuk ka lidhje gjaku me dhuruesin, vetëm me kusht që:
    - i) dhuruesi të deklarojë me shkrim në mënyrë të qartë dëshirën për t'i dhuruar përfituesit indet, qelizat e tij/saj;
    - ii) dhurimi në fjalë të jetë miratuar nga Komiteti i Etikës Mjekësore.
2. Heqja e indeve, qelizave apo organeve nga një dhurues mund të kryhet vetëm pasi dhuruesi dhe përfituesi të kenë deklaruar gatishmërinë për të marrë pjesë në programin e kujdesit të rekomanduar nga mjekët në fazën pas heqjes.

#### Neni 20

#### **Realizimi i heqjes së indeve rigjeneruese nga dhuruesi i mitur ose personi i paaftë**

Për personat e mitur dhe personat e paaftë mund të realizohet vetëm heqja e indit rigjenerues kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) nuk ekziston një dhurues i mundshëm, i përshtatshëm, në gjendje të japë pëlqimin e tij të qartë dhe konkret;
- b) përfituesi është prind, fëmijë, vëlla ose motër e dhuruesit;
- c) dhurimi përfaqëson një mundësi për të shpëtuar jetën e përfituesit;
- ç) përfaqësuesi ligjor i dhuruesit, të miturit apo një personi të paaftë, ka shprehur pëlqimin e tij/saj për dhurimin sipas nenit 15 të këtij ligji;
- d) Komiteti i Etikës Mjekësore ka miratuar dhurimin në fjalë.

SEKSIONI II  
HEQJA E INDIT APO ORGANIT NGA PERSONA QË NUK JETOJNË

Neni 21

**Heqja e indeve apo organeve nga një dhurues që nuk jeton**

1. Heqja e indit apo organeve nga trupi i një personi që nuk jeton mund të realizohet vetëm nëse personi në fjalë gjatë jetës së tij/saj ose përfaqësuesi ligjor i të miturit apo i personit të paafët nuk kanë shprehur hapur mosmiratimin e tyre. Në këto raste, dhënia e pëlqimit për heqjen e indit apo organit merret nga të afërmit e tij/saj, sipas kësaj radhe: bashkëshortja, bashkëshorti, fëmija madhor, prindi, motra, vëllai.

2. Heqja e organit apo indit nga një person që nuk jeton mund të realizohet vetëm në rastin kur vdekja provohet në përputhje me kriteret mjekësore, të përcaktuara në rregulloren e miratuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë për certifikimin e vdekjes.

3. Vërtetimi i vdekjes së një dhuruesi të mundshëm realizohet gjithmonë nga tre mjekë të kualifikuar, të cilët e ekzaminojnë dhuruesin në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

4. Mjekët, që certifikojnë vdekjen, nuk marrin pjesë në procesin e transplantimit.

Neni 22

**Ndalimi i heqjes së indit dhe organit nga një dhurues që nuk jeton**

1. Heqja e indit dhe organit nga një dhurues që nuk jeton ndalohet kur:

a) personi, që nuk jeton gjatë jetës së tij/saj ose përfaqësuesi ligjor i personit në fjalë, i cili është një i mitur ose një person i paafët, ka kundërshtuar shprehimisht heqjen pas vdekjes së indeve dhe organeve;

b) të afërmit e tij nuk japin pëlqimin për heqjen e indit apo organit të personit të vdekur;

c) në bazë të vlerësimit të aftësisë shëndetësore, nuk është e mundur të përjashtohet se personi, që nuk jeton, vuante nga një sëmundje apo gjendje, e cila mund të rrezikojë shëndetin dhe jetën e përfituesit;

ç) është e pamundur të identifikohet personi që nuk jeton.

2. Procedurat e vlerësimit të aftësisë shëndetësore, si dhe ekzaminimet që i bëhen dhuruesit që ka ndërruar jetë, përcaktohen me rregullore, të miratuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

3. Heqja e indit apo organit nga një shtetas i huaj, që nuk jeton, mund të bëhet në bazë të marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare.

Neni 23

**Indet dhe organet e hequra**

1. Mbas realizimit të heqjes së indit apo organit, mjeku regjistron listën e indeve dhe të organeve të hequra, si dhe qëllimin e menduar të përdorimit të tyre në të dhënat mjekësore të dhuruesit.

2. Indet dhe organet e hequra mund të dorëzohen për ekzaminime, përpunime, përgatitje, konservim, ruajtje dhe shpërndarje të mëtejshme vetëm pranë një banke indesh apo organesh.

Neni 24

**Respekti për trupin e njeriut**

Gjatë heqjes së organit apo indit dhe gjatë ekzaminimeve pas vdekjes, trupi i njeriut duhet të trajtohet me respekt dhe të gjitha procedurat duhet të realizohen në mënyrë të tillë që trupi të mund të rikthehet në pamjen e tij origjinale sa më shumë që të jetë e mundur.

SEKSIONI III  
RASTE TË VEÇANTA

Neni 25  
**Mosrealizimi i heqjes së transplantit**

Heqja e transplantit nga dhuruesi nuk realizohet nëse:

- a) gjykohet se transplantit mund të rrezikojë seriozisht shëndetin ose jetën e dhuruesit;
- b) dhuruesi është një person, i cili është në paraburgim ose po vuan dënimin me heqje lirie. Përrjashtim bëjnë rastet e dhurimit ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të tyre, ndërmjet vëllezërve dhe motrave ose ndërmjet bashkëshortëve;
- c) gjatë vlerësimit të gjendjes shëndetësore të dhuruesit, shfaqet dyshimi se dhuruesi vuan nga një sëmundje apo gjendje, e cila mund të rrezikojë shëndetin apo jetën e përfituesit. Kjo nuk aplikohet për rastet kur rreziku ndaj shëndetit të përfituesit është i vogël krahasuar me transplantin që i shpëton atij/asaj jetën.

Neni 26  
**Heqja me kusht nga dhuruesi**

1. Heqja e indit, qelizave apo organit nga një dhurues që jeton mund të realizohet vetëm në dobi të personit të caktuar nga dhuruesi.
2. Në rast se transplantit i hequr nuk mund të transplantohet në trupin e një personi të caktuar, është e nevojshme që, para realizimit të heqjes, të sigurohet pëlqimi i dhuruesit për të përdorur indin, qelizat apo organin për një person tjetër.
3. Arsytet, që çojnë mjekun të marrë vendimin që transplantit i hequr nuk mund të implantohet në personin e caktuar nga dhuruesi, shënohen në të dhënat mjekësore të dhuruesit dhe të personit të caktuar nga ana e dhuruesit.

KREU V  
SIGURIA DHE CILËSIA

Neni 27  
**Menaxhimi i cilësisë**

1. Ministria e Shëndetësisë ndërmerr të gjitha masat për të garantuar që strukturat shëndetësore të transplantimit të zbatojnë dhe të përditësojnë një sistem cilësie, të bazuar në parimet e praktikës së mirë.
2. Sistemi i cilësisë së transplantit përfshin standardet dhe rregullat që kanë të bëjnë me:
  - a) sistemin e dokumentacionit;
  - b) mjedisin dhe pajisjet;
  - c) stafin;
  - ç) procedurën e përzgjedhjes dhe të seleksionimit të dhuruesve të indeve, qelizave dhe organeve;
  - d) procedurat e pranimit të indeve, qelizave dhe organeve në bankat e indeve dhe qelizave;
  - dh) procedurën e testimit e të përpunimit;
  - e) procedurën e etiketimit, të dokumentimit, paketimit, depozitimit dhe shpërndarjes së indeve, qelizave dhe organeve;
  - ë) procedurën e trajtimit të indeve, qelizave dhe organeve që do të asgjësohen, me qëllim parandalimin e kontaminimit të indeve dhe qelizave të tjera, mjedisit të përpunimit apo personelit.
3. Strukturat shëndetësore të transplantimit ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme:
  - a) për të garantuar që sistemi i cilësisë të përfshijë të paktën dokumentacionin e mëposhtëm:

- i) procedurën operative standarde për çdo procedurë që kryhet;
  - ii) udhëzuesit;
  - iii) manual trajnues dhe referues;
  - iv) formular raportimi;
  - v) të dhëna të dhuruesit;
  - vi) të dhëna për destinacionin përfundimtar të indeve, qelizave dhe organeve;
- b) për të garantuar që ky dokumentacion të jetë i disponueshëm për inspektim nga ana e autoritetit/autoriteteve kompetent/kompetente.
4. Strukturat shëndetësore të transplantimit mbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme për të garantuar gjurmimin.
5. Rregullat për vlerësimin e cilësisë dhe të sigurisë së indeve, qelizave dhe organeve për qëllime transplantimi përcaktohen me rregulloren e miratuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

#### Neni 28

### **Akreditimi dhe licencimi**

1. Akreditimi i strukturave shëndetësore, që kryejnë veprimtarinë e transplantimit të indeve e qelizave kryhet nga Qendra Kombëtare e Cilësisë, Certifikimit dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Licencimi i strukturave shëndetësore, që do të realizojnë procesin e transplantimit të indeve, qelizave dhe organeve në Republikën e Shqipërisë, do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 29

### **Importi dhe eksporti i indeve, qelizave dhe organeve**

1. Importi dhe eksporti i indeve, qelizave dhe organeve, për qëllime transplantimi, autorizohen nga Ministri i Shëndetësisë.
2. Procedurat përkatëse dhe dokumentacioni i detyrueshëm, që duhet të plotësojë banka e indeve, qelizave dhe organeve, që është struktura shëndetësore që kryen importin dhe eksportin e transplanteve, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.
3. Lista e kërkesave, që duhet të plotësojnë indet, qelizat dhe organet e importuara nga vendet e tjera, përfshirë mënyrat e kushtet e gjurmimit, regjistrimin e të dhënave të gjurmimit e verifikimit e dhënies së transplanteve, sistemi i deklarimit të efekteve të padëshiruara, si dhe procedura për verifikimin e standardeve të barasvlershme të cilësisë dhe të sigurisë përcaktohen me rregullore të veçantë, të miratuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

#### Neni 30

### **Inspektimi**

1. Ministria e Shëndetësisë është autoriteti inspektues i strukturave shëndetësore të transplantimit, që organizon inspektimin dhe merr masat përkatëse për zbatimin e kërkesave të ligjit. Procedurat e inspektimit rregullohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.
2. Përfaqësuesit e autoritetit inspektues kanë të drejtë:
  - a) të inspektojnë periodikisht qendrat ky kryhen veprimtaritë e lidhura me transplantimin e indeve, qelizave dhe organeve. Intervali ndërmjet dy inspektimeve nuk duhet t'i kalojë dy vite;
  - b) të vlerësojnë dhe të verifikojnë procedurat dhe veprimtaritë e kryera në qendrat e transplantimeve;
  - c) të kontrollojnë çdo dokument apo të dhënë tjetër që lidhet me objektin e inspektimit.

Neni 31  
**Gjurmimi**

1. Me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë miratohet rregullorja për krijimin dhe funksionimin e sistemit të gjurmimit për:

a) gjurmimin nga dhuruesi drejt përfituesit dhe anasjelltas të organeve, indeve dhe qelizave të përzgjedhura, të përpunuara, të ruajtura apo të shpërndara në territorin e vendit. Gjurmimi aplikohet, gjithashtu, për të gjitha të dhënat përkatëse, që lidhen me produktet dhe materialet, të cilat vijnë në kontakt me indet, qelizat dhe organet në fjalë;

b) implementimin e një sistemi identifikimi të dhuruesit, të cilit i bashkëngjitet një kod i veçantë për secilin dhurim dhe produkt që lidhet me të;

c) regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave të nevojshme për të garantuar gjurmimin në të gjitha fazat.

2. Të dhënat e kërkuara për gjurmimin e plotë ruhen për një periudhë minimale prej 30 vjetësh pas përdorimit klinik. Të dhënat, gjithashtu, mund të ruhen në formë elektronike.

Neni 32  
**Njoftimi i efekteve të padëshiruara**

1. Të gjitha qendrat, që realizojnë implantimin e transplantit me origjinë njerëzore, raportojnë çdo efekt të padëshiruar pranë bankave të indeve, qelizave dhe organeve.

2. Banka e indeve, qelizave edhe organeve njoftohet për çdo rast apo për efekte të padëshiruara dhe pajiset nga struktura raportuese me një raport, ku analizohen shkaku dhe rezultati.

3. Procedura për njoftimin e efekteve të padëshiruara, si dhe përpunimin e të dhënave për rastet e efekteve të padëshiruara në të gjitha hallkat e procesit përcaktohet me rregullore, të miratuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

4. Bankat e indeve, qelizave dhe organeve garantojnë një procedurë të saktë, të shpejtë dhe të verifikueshme, e cila mundëson tërheqjen nga qarkullimi të çdo produkti, i cili mund të lidhet me efektet e padëshiruara, të raportuara.

Neni 33  
**Ruajtja e konfidencialitetit**

1. Strukturat shëndetësore, që kryejnë veprimtari në fushën e transplantit, duhet të sigurojnë ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, në mënyrë që të mos identifikohen, si dhuruesi ashtu dhe përfituesi, sipas kërkesave të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për ruajtjen e konfidencialitetit, institucionet përkatëse duhet të marrin masat për:

a) ruajtjen e sistemit të të dhënave, si dhe ruajtjen nga çdo shtesë, heqje apo modifikim i paautorizuar i të dhënave në dosjen e dhuruesit apo nga zhvendosja dhe transferimi i të dhënave;

b) hartimin e procedurave për të zgjidhur mospërputhjen e të dhënave dhe nxjerrjen e paautorizuar të tyre për të garantuar gjurmimin e dhurimeve;

c) të garantuar që identiteti i përfituesit të mos i bëhet i njohur dhuruesit apo familjes së tij/saj dhe anasjelltas kryesisht në rastin e dhurimit të qelizave riprodhuese;

ç) garantimin e të dhënave të dhuruesve gjatë gjithë procesit të gjurmimit.

3. Përjashtim bëjnë rastet kur të dhënat bëhen të njohura me pëlqimin e dhuruesit, përfituesit ose një përfaqësuesi ligjor, por gjithnjë pa cenuar anonimatën e palës tjetër.

## KREU VI SANKSIONET

### Neni 34 Sanksionet

1. Shkeljet e mëposhtme kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) kryerja e veprimeve të ndaluara, të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë ose me heqje të së drejtës të ushtrimit të profesionit për 3 vjet;

b) kryerja e procesit të transplantimit të indit, qelizës apo organit pa marrjen e konsensusit nga dhuruesi, në shkelje të nenit 15 të këtij ligji, dënohet me heqje të së drejtës të ushtrimit të profesionit për 3 vjet;

c) kryerja e procedurës së transplantimit, pa respektuar procedurat e parashikuara në nenet 19 dhe 20 të këtij ligji, dënohet me heqje të së drejtës për ushtrim profesioni, personit përgjegjës për 3 vjet dhe pezullim të titullit të strukturës përkatëse për një periudhë 12-mujore. Në rast përsëritjeje, revokim të titullit të strukturës përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) kryerja e transplantimit të indit apo organit nga një shtetas i huaj pa një marrëveshje ndërkombëtare, në shkelje të pikës 3 të nenit 22 të këtij ligji, dënohet me heqje të së drejtës për ushtrim profesioni të personit përgjegjës për 3 vjet dhe pezullim të titullit të strukturës përkatëse për një periudhë 12-mujore. Në rast përsëritjeje, revokim të titullit të strukturës, përkatëse sipas legjislacionit në fuqi;

d) heqja e transplantit nga dhuruesi kur rrezikohet jeta e tij, kur është në paraburgim apo vuan dënimin me heqje lirie, vuan nga një sëmundje që mund të rrezikojë jetën e përfituesit, në shkelje të nenit 25 të këtij ligji, dënohet me heqje të së drejtës për ushtrim profesioni për 3 vjet dhe pezullim të titullit të strukturës përkatëse për një periudhë 12-mujore. Në rast përsëritjeje, revokim të titullit të strukturës përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) mosnjoftimi i efekteve të padëshiruara nga qendrat që kryejnë transplantimin, në shkelje të pikës 1 të nenit 32 të këtij ligji, dënohet me 500 000 (pesëqind mijë) lekë gjobë;

e) shkelja e kushteve të konfidencialitetit, të parashikuara në nenin 33 të këtij ligji, nga ana e strukturave shëndetësore dënohet me heqje të së drejtës për ushtrim profesioni për 3 vjet.

2. Kryerja e importit dhe eksportit të transplantive pa autorizimin e Ministrit të Shëndetësisë, në shkelje të nenit 29 të këtij ligji, përbën vepër penale dhe dënohet sipas dispozitave të Kodit Penal.

3. Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e gjobës është Ministria e Shëndetësisë. Autoritetet përgjegjëse për heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit janë urdhrat profesionistë.

4. Procedurat për vënien e gjobës dhe ankimin rregullohen me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

## KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 35 Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, pas hyrjes në fuqi të ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9 pika 4, 11 pika 2 dhe 18 pika 3 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë që, pas hyrjes në fuqi të ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 pika 3, 10 pika 3, 13 pika 1, 16 pikat 3 e 4, 17 pika 3, 21 pika 2, 22 pika 2, 27 pika 5, 29 pikat 2 e 3, 30 pika 1, 31 pika 1 dhe 32 pika 3 të këtij ligji.

Neni 36  
**Shfuqizime**

Ligji nr. 8193, datë 6.2.1997 “Për transplantimin e organeve” dhe çdo akt tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 37  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7068, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 455, datë 21.7.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 076, DATË 12.2.2009 “PËR SIGURIMIN E  
DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 10**

**Kushtet dhe tarifat e sigurimit të detyrueshëm**

1. Autoriteti miraton rregullat për përcaktimin e kushteve të përgjithshme të sigurimit të detyrueshëm dhe nivelin e rezervave teknike dhe provigjoneve.

2. Shoqëria e sigurimit përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, dhe fillon t’i zbatojë ato, pasi njofton zyrtarisht autoritetin. Pavarësisht tarifave të liberalizuara të primit të sigurimit të detyrueshëm, shoqëritë e sigurimit krijojnë rezervat teknike dhe provigjonet, jo më pak se niveli i rezervave teknike dhe provigjoneve, të përcaktuara nga autoriteti, si në pikën 1 të këtij neni.

3. Kur autoriteti vëren se kushtet e përgjithshme të sigurimit nuk janë në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore, miraton vendime, të cilat trajtojnë mënyrën, sipas së cilës shoqëria e sigurimit duhet t’i përputhë ato.”.

**Neni 2**

Në nenin 52 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” e pikës 3 ndryshohet si më poshtë:  
“b) zbaton kushte të përgjithshme sigurimi, në kundërshtim me nenin 10 të këtij ligji.”.
2. Shkronja “b” e pikës 5 shfuqizohet.

#### Neni 3

Në nenin 59, pika 2 ndryshohet si më poshtë:  
“2. Pikat 1 dhe 5 të nenit 100 të ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, të ndryshuar, shfuqizohen.”.

#### Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7069, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

### **LIGJ Nr. 10 456, datë 21.7.2011**

#### **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002 “PËR AKCIZAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

Në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

#### Neni 1

Në nenin 19 “Përjashtimet”, në fund të pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:  
“Rimbursimi i akcizës së përcaktuar në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh” të kësaj pike kryhet çdo muaj. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, me përjashtim të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në masën e akcizës së pretenduar për rimbursim.”.

#### Neni 2

Në nenin 24/1 pika 2, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:  
“Pulla fiskale në formën e kodit të sigurisë aplikohet edhe në produkte të tjera të pijeve alkoolike, përfshirë edhe birrën e importuar, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.”.



Neni 3

Shtojca 1, që i bashkëlidhet ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën, me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7070, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**SHTOJCA NR 1  
MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla tatimore
<b>I</b>		
<b>KAFE</b>		
09 01 1100 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	30 lekë/kg
09 012100 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	140 lekë/kg
09 01 9021	Lëkura dhe lëvoret e kafesë, zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
21 01 11 21 01 12	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	250 lekë/kg
<b>II</b>		
<b>BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE</b>		
22 03	Birrë e bërë nga malto - nga prodhues vendas e të huaj me sasi deri në 70 000 hektolitra në vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi nga 70 001 deri në 200 000 hektolitra në vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi nga 200 001 deri në 300 000 hektolitra në vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi më të madhe se 300 000 hektolitra në vit	10 lekë/litri 12 lekë/litri 15 lekë/litri 30 lekë/litri
22 04	Verë dhe verërat e gazuara; shampanjë; musht rrushi - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 10 000 hektolitra/vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 10 000 hektolitra/vit	20 lekë/litri 35 lekë/litri
22 05	Vermut e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 300 hektolitra/vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 300 hektolitra/vit	20 lekë/litri 35 lekë/litri
22 06	Të tjera pije të fermentuara (p.sh. cider, cider dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të papërmendura diku tjetër	20 lekë/litri
22 07 10 00	Alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80 për qind ose më tepër	400 lekë/litri
22 07 20 00	Alkool etilik i denaturuar	0
22 08	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit mbi 12 për qind	

	- nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 20 000 hektolitra/vit	220 lekë/litri
	- nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 20 000 hektolitra/vit	300 lekë/litri
	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit deri në 12 për qind	100 lekë litri
22 08 20 29	Raki	100 lekë/litri
<b>III DUHANI DHE NËNPRODUKTET E TIJ DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ</b>		
24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 500 lekë/kg
24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	70 lekë/paketa
24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg
24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	1 500 lekë/kg
<b>IV NËNPRODUKTET E NAFTËS</b>		
27 10 11 11	Naftë virgine	50 lekë/litri
27 10 11 41	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol), Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër	37 lekë/litri
27 19 11 45	Me më pak se 95 oktan	
27 10 11 49	Me 95-98 oktan	
	Me 98 e më shumë oktan	
27 10 11 51	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër	50 lekë/litri
27 10 11 59	Me më pak se 98 oktan	
	Me 98 e më shumë oktan	
27 10 19 11 deri	Vajguret	20 lekë/litri
27 10 19 29	Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri
27 10 19 21		
27 10 19 31 deri	Vajra të rënda (gazoil)	37 lekë/litri
27 10 19 49		
27 10 19 51 deri	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	37 lekë/kg
27 10 19 69		
27 10 19 71 deri	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg
27 10 19 99		
27 13 1100	Koks nafte	2 lekë/kg
27 13 12 00		
27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg
27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
27 14 90 00	- Të tjera (bitum dhe asfalt natyral; asfaltet dhe gurët asfaltikë)	5 lekë/kg
27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpentinën e katranit mineral (masticet bituminoze) Vernik Bituminoz	5 lekë/kg
29 0129 02	Hidrokarbure aciklike dhe ciklike, përfshirë (etilen, benzen, toluol, ksilol)	37 lekë/kg

34 03 19 91	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg
34 03 99 10		
<b>V FISHEKZJARRËT</b>		
36 04 10 00	Fishekzjarrët	200 lekë/kg
36 04 90 00	Të tjera	200 lekë/kg
<b>VI GOMAT</b>		
40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	20 lekë/kg
40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës	40 lekë/kg
40 12 20 00	Goma pneumatike të përdorura	100 lekë/kg
<b>VII PILAT DHE BATERITË PRIMARE; AKUMULATORËT ELEKTRIKË</b>		
85 06	Pilat dhe bateritë primare	200 lekë/kg
85 07	Akumulatorët elektrikë, përfshi ndarëset e tyre, nëse janë apo jo drejtkëndëshe (përfshi katrorët)	20 lekë/kg
<b>VIII AMBALAZHET</b>		
	AMBALAZHET: Ambalazhet e plastikës Ambalazhet e qelqit Ambalazhi i përzier	100 lekë/kg 10 lekë/kg 20 lekë/kg
<b>IX LLAMBA INKANDESHENTE</b>		
85 39 22 10	Llambat reflektor	100 lekë/copa
85 39 22 90	Të tjera	100 lekë/copa
85 39 29 92	Më tepër se 100 V	100 lekë/copa
85 39 29 98	Jo më tepër se 100V	100 lekë/copa

**LIGJ**  
**Nr.10 457, datë 21.7.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 9 “Llojet e taksave vendore” pika 6 shfuqizohet.

Neni 2

Neni 30 “Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor” shfuqizohet.

Neni 3

Neni 31 “Përjashtimi nga pagimi i taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor” shfuqizohet.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7071, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

### **LIGJ**

**Nr.10 458, datë 21.7.2011**

### **PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008 “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 “Llojet e taksave kombëtare” bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Taksa e qarkullimit për benzinën (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 11 41, 2710 11 45, 2710 11 49, 2710 11 51, 2710 11 59) dhe për gazoilin (sipas kodeve tarifore 2710 19 31, 2710 19 35, 2710 19 41, 2710 19 45, 2710 19 49).”.

b) Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Taksa e karbonit për benzinën (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 11 41, 2710 11 45, 2710 11 49, 2710 11 51, 2710 11 59), për gazoilin (sipas kodeve tarifore 2710 19 31, 2710 19 35, 2710 19 41, 2710 19 45, 2710 19 49), për qymyrin, me krerë tariforë të NKM-së 2701 dhe 2702, për vajgurin (sipas kodeve tarifore 2710 19 11 deri 2710 19 29), për solarin (sipas kodit tarifor 2710 19 61), për mazutin (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 19 63, 2710 19 65 dhe 2710 19 69) dhe për koks nafte (sipas krerëve tariforë të NKM-së 2713 11 00 dhe 2713 12 00).”.

Neni 2

Në nenin 4 “Niveli i taksave kombëtare” bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin caktohet në masën 5 lekë për litër deri më 31.12.2011, pas kësaj date taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin caktohet në masën 7 lekë për litër. Kjo taksë zbatohet si për benzinën dhe gazoilin e importuar, ashtu edhe për ato të prodhuara në vend.”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm<sup>3</sup> x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit.

Taksa fikse për llojin e karburantit është 25 lekë për naftën dhe 20 lekë për benzinën.

Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij ligji, dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, taksa llogaritet proporcionalisht për periudhën e mbetur të vitit. 18 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësisë të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësisë të qeverisjes vendore.”.

c) Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Taksa e karbonit caktohet në masën 1,5 lekë për litër për benzinën, 3 lekë për litër për gazoilin, 3 lekë për kilogram për qymyrin, 3 lekë për litër për solarin, 3 lekë për litër për mazutin, 3 lekë për litër për vajgurin dhe 3 lekë për kilogram për koks naftë.”.

### Neni 3

Në nenin 5 “Agjentët e taksave” bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për taksën e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për benzinën dhe gazoilin e prodhuar në vend.”.

2. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) Për taksën vjetore të mjeteve të përdorura ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.”.

3. Shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të doganave në rrethe, për taksën e karbonit për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koxsin e naftës e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koxsin e naftës të prodhuar në vend, në bazë të sasive të prodhimit.”.

### Neni 4

Në nenin 7 “Taksat që vilen nëpërmjet pullës”, fjalët “taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve” zëvendësohen me fjalët “taksa vjetore e mjeteve të përdorura”.

### Neni 5

Në nenin 8 “Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave” pika 2 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) për taksën e qarkullimit, 0 për qind.

2. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, 5 për qind.”.

#### Neni 6

Në nenin 9 “Përfundimet nga pagimi i taksave kombëtare”, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përfundohen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) personat fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë, brenda muajit janar të vitit në vazhdim, se nuk do të qarkullojnë me mjetet në pronësi të tyre gjatë këtij viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit të mjetit;

c) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, prokurorisë, etj., për periudhën në të cilën mjete ka qenë i bllokuar;

ç) autoveturat tip 4+1 vende dhe me cilindratë jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse, dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private;

d) makinat bujqësore.”.

#### Neni 7

Në nenin 11, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) tarifa e shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja të transportit të udhëtarëve të më shumë se 20 personave, përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, si dhe të mjeteve të transportit të mallrave me ngarkesë apo pa ngarkesë përcaktohet me reciprocitet.”.

#### Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7072, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

#### SHTOJCA NR. 1

#### KOEFICIENTËT SIPAS VJETËRSISË PËR TAKSËN VJETORE TË MJETE TË PËRDORURA

Motomjete, autovetura, automjete për transport të përzier		Të gjitha llojet e tjera të mjeteve		Autobusët	
Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit
1	0,00	1	0,00	1	0,00
2	0,00	2	0,00	2	0,00
3	0,00	3	0,00	3	0,00
4	0,18	4	0,20	4	0,07
5	0,19	5	0,22	5	0,08
6	0,20	6	0,24	6	0,09

7	0,21	7	0,26	7	0,10
8	0,22	8	0,28	8	0,11
9	0,23	9	0,30	9	0,12
10	0,24	10	0,32	10	0,13
11	0,28	11	0,34	11	0,14
12	0,32	12	0,36	12	0,15
13	0,36	13	0,38	13	0,16
14	0,40	14	0,40	14	0,17
15	0,44	15	0,42	15	0,20
16	0,48	16	0,44	16	0,23
17	0,52	17	0,46	17	0,26
18	0,56	18	0,48	18	0,29
19	0,60	19	0,50	19	0,32
20	0,64	20	0,52	20	0,35
21	0,68	21	0,54	21	0,38
22	0,70	22	0,56	22	0,40
23	0,72	23	0,58	23	0,42
24	0,74	24	0,60	24	0,44

Shënim: Pas vitit të 24-t të përdorimit, për autobusët koeficienti rritet me 0,03 dhe për të gjitha mjetet e tjera rritet me 0,0, ndërsa për motomjetet, autoveturat, automjetet për transport të përzier rritet me 0,04.

**LIGJ**  
**Nr.10 459, datë 21.7.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9981, DATË 8.9.2008 “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Nivelet tarifore të disa artikujve, të përcaktuara në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur ligjit nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, ndryshojnë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7073, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bamir Topi**

ANEKSI 1

Kodi NK	Përshkrimi	Tarifa %	Tarifa bëhet (%)
3405	Lustruesit, kremrat dhe preparate të ngjashme për veshjet e këmbëve	6	0
3506	Tutkallet e përgatitura dhe lëndë të tjera ngjitëse të përgatitura, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; produktet e përshtatshme për t'u përdorur si tutkall apo si ngjitës, vendosur për shitjen me pakicë si tutkall apo si lëndë ngjitëse, që nuk e kalon 1 kg të peshës	6	0
3507	Enzimmat; enzimmat e përgatitura të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	6	0
3926 20 00	Artikuj të veshjes dhe plotësues të veshjes (përfshirë dorezat)	6	0
4001	Gomë natyrale, balata, gutta-percha, guayule, chicle dhe goma të ngjashme natyrale, në forma primare apo në pllaka, fletë apo shirita	2	0
4002	Goma termoplastike, granulat	2	0
4016	Artikuj të tjerë prej gome të vulkanizuar të tjera nga goma e fortë	15	0
4017	Guaine	15	0
4107	Lëkurë e përpunuar më tej pas regjies apo tharjes, përfshirë lëkurën e veshur pergamene, të gjedhëve (përfshirë dhe buajt) apo kuajve, pa qime, nëse është e ndarë apo jo, përveç lëkurës së kreut 4114	10	0
4112	Lëkurë e përpunuar më tej pas regjies apo tharjes, përfshirë lëkurën e veshur pergamene, të deleve apo qengjave, pa lesh, nëse është e ndarë apo jo, përveç lëkurës së kreut 4114	10	0
4113	Astar lëkure	10	0
4113	Lëkurë e përpunuar më tej pas regjies apo tharjes, përfshirë lëkurën e veshur pergamene, të kafshëve të tjera, pa lesh ose qime, nëse është e ndarë apo jo, përveç lëkurës së kreut 4114	10	0
4205	Artikuj të tjerë prej lëkure apo prej lëkure të rindërtuar	15	0
4206	Shirit lëkure	15	0
5006	Fije mëndafshi	2	0
5007	Pëlhurë mëndafshi	10	0
5204	Fije pambuku për qepje	2	0
5205	Fije pambuku për qepje	2	0
5206	Fije pambuku për qepje	2	0
5207	Fije pambuku për qepje	2	0
5208	Pëlhurë pambuku	10	0
5209	Pëlhurë pambuku	10	0
5210	Pëlhurë pambuku	10	0
5211	Pëlhurë pambuku	10	0
5212	Pëlhurë pambuku	10	0
5309	Pëlhurë prej liri	10	0
5310	Pëlhurë jute	10	0
5311	Pëlhura të tjera	10	0
5401	Fije sintetike për qepje	2	0
5402	Fije sintetike për qepje	2	0



5403	Fije artificiale	2	0
5407	Pëlhurë prej fileve sintetike	10	0
5603	Pëlhura të paendura, nëse janë apo jo të ngopura, veshura, mbuluara apo laminuara	10	0
5801	Pëlhurë kadife	10	0
5804 21 90	- te tjera (tantella)	10	0
5807	Etiketa	10	0
5901	Pëlhura tekstile të veshura me ngjitës apo substanca niseshteje, të një lloji të përdorur për mbulues të jashtëm të librave apo të të ngjashmëve të tyre; tekstil i tejdukshëm; kanavacë e përgatitur për piktura; pëlhura të ngrira për lidhjen e librave dhe pëlhura të ngjashme tekstile të ngrira të një lloji të përdorur për skeletet e kapeleve	10	0
5902	Kordona pëlhure për gommat pneumatike prej fijeve me viskozitet të lartë prej najloni apo poliamideve të tjera, prej poliestereve apo prej rajon viskoze	10	0
5903	Pëlhura tekstile të ngopura, të veshura, të mbuluara apo të laminuara me plastike, përveç atyre te kreut 5902	10	0
5904	Astar sintetik	10	0
6001	Astar poliakrilik	10	0
6002	Pëlhura të thurura me një fije apo me shumë fije të një gjerësie jo më tepër sesa 30 cm, që përmbajnë ndaj peshës 5 % apo më shumë fije elastomerike apo fije gome të ndryshme nga ato të kreut 6001	10	0
6003	Pëlhura të thurura me një fije apo me shumë fije të një gjerësie jo më tepër sesa 30 cm, të ndryshme nga ato të krerëve 6001 apo 6002	10	0
6006 22 00	Të lyera - Pëlhura të tjera të thurura me një fije apo me shumë fije	10	0
6006 32 90	Të tjera, prej fibrave sintetike	10	0
6006 42 00	Të lyera, prej fibrave artificiale	10	0
61 17 90 00	Pjesët - (Plotësues të tjerë të ndërtuar të veshjeve, të thurura me një fije apo me shumë fije; pjesë të veshjeve apo të plotësuesve të tyre të thurura me një fije apo me shumë fije)	15	0
6217	Aksesorët e qepjes	15	0
6307	Lidhëse	10	0
6406	Veshje këmbësh, pjesë veshje këmbësh	10	0
6406	Kondraforte	10	0
8308	Gambriioni, precina, syska, file, spango, të tjera përfshirë pjesët	15	0
9606	Butona, kopsa etj.	15	0
5806 20 00	Fjongot gallone të endura, të ngjashmet që përmbajnë vetë ndaj peshës 5% apo më shumë fije elastomerike apo fije gome pëlhura të ngushta të përbëra nga baza pa indin të bashkuara nëpërmjet një ngjitësi (bolducs)	10	0
5807 10 10	me shkrime të endura	10	0
5807 10 90	të tjera	10	0
7018 10 30	imitacione perlash	15	0
7326 20 30	Kafazë të vegjël dhe të mëdhenj (Artikuj prej telave të gizës apo të çelikut)	15	0

5808 90 00	Të tjera	10	0
Kapitulli 61	ARTIKUJ TË VESHJES DHE PJESE SHITESË PËR VESHJE, TË THURURA ME SHUMË FIJE APO NJË FIJE	15	0
Kapitulli 62	ARTIKUJ TË VESHJES DHE PLOTËSUES TË VESHJEVE, JO TË THURURA ME NJË APO ME SHUMË FIJE	15	0

**VENDIM**  
**Nr.32, datë 22.7.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 31.3.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.8 Akti që i përket:

**KËRKUES:** Ukë Sheta, përfaqësuar nga avokatët Dhimitraq Prifti dhe Artur Mickaj me prokurë të posaçme.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

FIFE KASTRATI, përfaqësuar nga avokat Besnik Kaçurri me prokurë të posaçme.

Drejtoria e administrimit dhe shitjes së pronës publike, përfaqësuar nga Sotiraq Veizi me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.426, datë 18.11.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, përfaqësuesit e kërkuarit që u shprehën për pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr.55, datë 20.2.2006, ka vendosur: “Rrëzimin e padisë së paditëses me objekt: shpalljen e pavlefshmërisë absolute të kontratës së privatizimit midis Ukë Shetës dhe Agjensia Kombëtare e Privatizimit (AKP) dega Kukës; rrëzimin e kundërpadisë së Ukë Shetës për kthimin e sendit.”

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.250, datë 10.7.2006, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr.55, datë 20.2.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës në këtë mënyrë: Deklarimin

e pavlefshëm të kontratës së privatizimit datë 30.8.1994 lidhur mes palës së paditur AKP dega Kukës dhe Ukë Shetës. Kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera të tij.”

Gjykata e Lartë, me vendimin nr.1174 (426) datë 18.11.2008, ka vendosur: “Pushimin e gjykimit të çështjes në Gjykatë të Lartë, për shkak se rekursi nuk i përmbahet kërkesave të nenit 475 të KPC-së.”

*Kërkuesi* pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar ndaj tij një proces të parregullt sepse:

- ka vendosur, në seancë gjyqësore, pushimin e çështjes pa dëgjuar kërkuesin, duke i mohuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe si rrjedhim edhe të drejtën e aksesit në gjykatë. Kolegji Civil, në seancë gjyqësore, ka deklaruar se rekursi nuk plotësonte shkaqet formale për pranimin e tij, gjë që bie ndesh me nenet 475 e 476 të KPC-së.

- ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes në kundërshtim me nenin 485 të KPC-së, i cili parashikon qartë shkaqet për të cilat vendoset pushimi i gjykimit të çështjes. Gjykata e Lartë është kompetente të vendosë pranimin ose rrëzimin e rekursit, pra të prishë ose të lërë në fuqi vendimin gjyqësor të rekursuar dhe jo ta pushojë atë.

*Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Fife Kastrati*, pretendon se kërkimet e kërkuesit janë të pabazuara, pasi:

- nuk ka shkelje të procesit të rregullt ligjor, sepse Gjykata e Lartë ka vepruar brenda kompetencave të veta. Kalimi në seancë i kërkesës për rekurs ka qenë i gabuar, pasi nuk ka pasur shkaqe të paraqitura nga kërkuesi për këtë qëllim.

- kërkuesit nuk i është mohuar e drejta e ankimit, pasi e ka ushtruar atë si në Gjykatën e Apelit Shkodër ashtu dhe në Gjykatën e Lartë.

*Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike*, pretendon se vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi, pasi:

- rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmbante elementet formale të parashikuara nga KPC-ja dhe për këtë arsye, Gjykata e Lartë me të drejtë ka vendosur pushimin e gjykimit.

- kërkuesi ka patur kohë të mjaftueshme për të bërë plotësimet në rekursin e ushtruar prej tij, megjithë vonesën e dhënies së vendimit të arsyetuar nga Gjykata e Apelit Shkodër.

## II

### *Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë*

Kërkuesi pretendon se shkak kryesor i mosparaqitjes së kundërshtimeve në rekursin e paraqitur para Gjykatës së Lartë për pabazueshmërinë e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër ka qenë marrja me vonesë e vendimit të arsyetuar të kësaj të fundit. Dosja me vendimin që kundërshtohet para Gjykatës së Lartë ka mbërritur në atë gjykatë rreth 5 muaj me vonesë. Kjo periudhë kohe, sipas tij, është jashtë çdo afati të arsyeshëm, çka e ka penguar realisht kërkuesin në ushtrimin e të drejtës së ankimit para Gjykatës së Lartë, duke i cenuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson se pretendimi i kërkuesit është i bazuar.

Nisur nga dosja dhe dokumentet e paraqitura në seancë, vihet re se vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër është shpallur me datë 10.7.2006. Rekursi është ushtruar në kufirin kohor të 30 ditëve për shkak se kërkuesi nuk ka qenë njohur ende me vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke synuar zënien e afatit procedural dhe duke rezervuar të drejtën për të paraqitur shkaqet në një moment të dytë, pra kur t’i vihej në dispozicion vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Apelit.

Nga vendimi i Kolegjit Civil rezulton se dosja gjyqësore e dërguar nga Gjykata e Apelit Shkodër në Gjykatën e Lartë ka mbërritur me datë 1.12.2006, pra 5 muaj me vonesë, ndërkohë që kërkuesi, duke mos u ndodhur në Shqipëri (ndodhet me banim në Belgjikë), nuk rezulton të ketë marrë dijeni për vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Apelit Shkodër. Megjithatë, Kolegji Civil me

datë 17.10.2007, në dhomë këshillimi, megjithëse në mungesë të shkaqeve të rekursit, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë. Nuk ka asnjë provë që tregon se kur është vënë në dijeni kërkuesi për vendimin e arsyetuar, me qëllim paraqitjen e shkaqeve të rekursit të tij para Gjykatë së Lartë.

Gjykata vlerëson se personi që ushtron ankim/rekurs është i interesuar të ndjekë fatin e ankimit të tij, por kjo nuk nënkupton se i takon vetëm atij përgjegjësia të ndjekë pafundësisht fatin e dosjes gjyqësore, e cila administrohet nga gjykata dhe jo nga kërkuesi (*Vendime të Gjykatës Kushtetuese nr.4/2005; nr.22/2006; nr.38/2010*). Për këtë arsye, Gjykata çmon se i takonte administratës gjyqësore të Gjykatë së Lartë ose të Gjykatës së Apelit Shkodër të njoftonte në kohë kërkuesin jo vetëm për përmbajtjen e vendimit që rekurshej, por edhe për plotësimin e kërkesave të ushtrimit të rekursit duke qenë se ajo administronte dhe dosjen gjyqësore me vendimin ndaj të cilit ushtrohej rekursi. Gjithashtu, nuk provohet me asnjë shkresë ose dokument tjetër që kërkuesi të jetë njoftuar nga administrata gjyqësore për mungesat në paraqitjen e rekursit, të cilat, në fund të fundit, nuk vareshin prej tij, por prej administratës gjyqësore. Kjo e fundit, në bazë të nenit 476/2 të KPC-së, ka detyrimin të verë në dijeni rekursuesin për mangësitë formale të rekursit.

Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se është detyrë e administratës gjyqësore të njoftojë ankuesin/rekursuesin kur dokumentacioni që shoqëron ankimin/rekursin është i paplotë. Ajo ka theksuar se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*Vendime të Gjykatës Kushtetuese nr.22/2006 dhe nr.5/2011*). Në vijim të këtij qëndrimi, Gjykata nuk e gjen të bazuar pretendimin e subjektit të interesuar, Fife Kastrati, se është detyrim vetëm i kërkuesit ose përfaqësuesit të tij të ndjekë fatin e dosjes, thjesht e vetëm sepse ai ishte i interesuar për vendimin. Neni 476 i KPC-së parashikon dokumentacionin përkatës që duhet të shoqërojë rekursin, si dhe përcakton detyrimin e sekretarisë së gjykatës, që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, të përcjellë zyrtarisht në sekretarinë e Gjykatës së Lartë dosjen përkatëse së bashku me dokumentet e mësipërme. Në rast se nuk plotësohen kushtet për rekurs, palës i caktohet një afat 10-ditor për të bërë plotësimet dhe, nëse pas këtij afati nuk bëhen plotësimet, rekursi kthehet. Gjykata e Apelit Shkodër ka vonuar për rreth 5 muaj dërgimin e dosjes gjyqësore në Gjykatë të Lartë dhe përveç kësaj nuk rezulton që vendimi i asaj gjykate t'i jetë njoftuar rregullisht kërkuesit ose mbrojtësit të tij apo t'i jetë kërkuar nga administrata gjyqësore plotësimi i dokumentacionit shoqërues të rekursit, duke i mohuar kërkuesit të drejtën e aksesit në gjykatë.

Gjithashtu, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatë së Lartë nuk ka vepruar në përputhje me rregullat procedurale lidhur me pranimin ose jo të rekursit për shqyrtim, kur ka vendosur pushimin e gjykimit me arsyetimin se nuk ka shkaqe, pasi çështja kishte kaluar në seancë. Në këtë mënyrë, Kolegji nuk i ka dhënë mundësi kërkuesit të dëgjohet lidhur me rekursin, duke i mohuar në këtë mënyrë kërkuesit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Është e vërtetë se Kolegji Civil e kishte kaluar çështjen për gjykim, megjithëse kërkuesi nuk i kishte parashtruar shkaqet për shkak të mosmarrjes dijeni të vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Apelit Shkodër. Megjithatë mungesa ose jo e shkaqeve duhej të ishte verifikuar paraprakisht nga Kolegji Civil, sipas detyrimit të nenit 475 të KPC-së. Por në fakt, Kolegji e ka kaluar çështjen për gjykim dhe pasi ka hapur seancën gjyqësore ka vendosur pushimin për shkak të mosparaqitjes së shkaqeve, çka vjen në kundërshtim me nenet 475, 476 dhe 485 të KPC-së.

Gjykata çmon se i dilte si detyrë Kolegjit Seleksionues të verifikonte se përse nuk ishin paraqitur shkaqet, sidomos kur provohet shkresërisht se dosja nga Gjykata e Apelit Shkodër ishte paraqitur 5 muaj me vonesë pas seancës kur ishte shpallur publikisht vendimi. Nëse arsyet për mosparaqitjen e shkaqeve të rekursit kishin të bënin me veprimet ose mosveprimet e administratës gjyqësore, atëherë Kolegji duhet të njoftonte kërkuesin duke i lënë kohën e nevojshme për të plotësuar dokumentacionin. Nëse kërkuesi nuk i kishte paraqitur shkaqet për faj të tij, atëherë Kolegji Seleksionues ishte në kushtet për të mospranuar rekursin për shqyrtim. Veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës).

Gjithashtu, Gjykata thekson se Kolegji Civil, përderisa kishte kaluar çështjen në seancë, kishte tashmë detyrimin t'i jepte mundësinë kërkuarit të shprehej mbi shkaqet e rekursit, për të vendosur më pas për pranimin ose jo të tij. Në momentin që çështja kalon për gjykim, prezumohet se kërkuarit i është njohur e drejta për t'u dëgjuar në një seancë publike nga një gjykatë e pavarur e paanshme dhe e caktuar me ligj, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Kolegji Civil, bazuar në nenin 485 të KPC-së, ka kompetencë të lërë në fuqi vendimin e kundërshtuar, ta prishë atë dhe ta rikthejë për gjykim në gjykatën përkatëse, por jo të pushojë çështjen në seancë për mungesë të shkaqeve formale. Mungesa e shkaqeve të rekursit nuk është kusht për të pushuar gjykimin, siç ka bërë Kolegji Civil, por është shkak për mospranimi e rekursit që vendoset në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve (neni 480 KPC). Po kështu, duke iu referuar nenit 483 të KPC-së rezulton se “*në seancën gjyqësore relatori paraqet faktet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit, përmbajtjen e vendimit të ankimuar dhe shkaqet e rekursit dhe të kundërrekursit. Pas relatimit kryetari fton avokatët të paraqesin mbrojtjen e tyre*”. Pra, dispozita e lidh zhvillimin e seancës gjyqësore me faktin që palët duhet të dëgjohen për pretendimet dhe bazueshmërinë e tyre në ligj dhe prova. Në këtë fazë nuk mund të diskutohet nëse janë plotësuar shkaqet për shqyrtim gjyqësor, pasi kjo gjë prezumohet se është kryer në fazën paraprake. Gjykata ka detyrimin të dëgjojë palët në seancën që zhvillohet për këtë qëllim. Kjo rezulton të mos jetë respektuar në gjykimin konkret nga Kolegji Civil duke passjellë një proces të parregullt në kuptimin kushtetues.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/1/g të Kushtetutës, si dhe në neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.426, datë 18.11.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes në Gjykatën e Lartë për rigjykim.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori

#### VENDIM

**Nr.33, datë 22.7.2011**

#### **NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 25.1.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.42/27 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Enver Boriçi, përfaqësuar nga avokat Vladimir Meçi me prokurë.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtuëshëm me Kushtetutën i vendimit nr.311, datë 12.3.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; vendimit nr.14, datë 20.3.2008 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe i vendimit nr.61, datë 26.12.2007 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42/1, 131/f, 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Sokol Berberin, përfaqësuesin e kërkuarit Enver Boriçi që kërkoji pranimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

1. Në datë 26.12.2007, me vendimin nr. 61, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuarit Enver Boriçi për kryerjen e veprave penale të pjesëmarrjes në organizatë kriminale; të shkatërrimit të pronës me zjarr, të dhunimit të varreve dhe përfundimisht e ka dënuar kërkuarin me 12 vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 14, datë 20.03.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për sa i takon veprave penale të pjesëmarrjes në organizatë kriminale dhe të shkatërrimit të pronës me zjarr, dhe ka vendosur prishjen e vendimit për veprën penale të dhunimit të varreve dhe në përfundim e ka dënuar kërkuarin me 10 vjet burgim.

3. Në datë 12.3.2010 me vendimin nr. 311, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari ndaj vendimit nr.14 datë 20.3.2008 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, duke e lënë këtë vendim në fuqi.

4. Në datë 21.07.2010, kërkuari i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese me pretendimin se gjykimi i zhvilluar ndaj kërkuarit është karakterizuar nga shkelje të rënda ligjore dhe të parimeve kushtetuese që e bëjnë procesin të parregullt. Më konkretisht, kërkuari parashtron:

4.1 Është shkelur parimi i paanshmërisë së gjykatës në gjykimin e çështjes: Në gjykimin në apel, në përbërje të trupit gjykues ka marrë pjesë një gjyqtare e cila nuk duhet ta gjykonte çështjen (Gjyqtarja S. D.). Kjo gjyqtare ka marrë pjesë në gjykimin e E.C. i akuzuar për pjesëmarrje në të njëjtën organizatë kriminale për të cilën është akuzuar më pas edhe kërkuari. Gjyqtarja S.D. në gjykimin ndaj kërkuarit ka përdorur si provë një vendim të dhënë (vendimin kundër E.C.) nga vetë ajo për akuzën e pjesëmarrjes në organizatë kriminale. Në të njëjta kushte papajtueshmërie ka qenë edhe gjyqtari F. P. në shkallë të parë, pasi ai ka marrë pjesë në një gjykim tjetër me objekt sekuestrimin e pasurive të vëna në kuadër të organizatës kriminale të A.B. Kërkuari është deklaruar fajtor si pjesëmarrës dhe anëtar i kësaj organizate. Këtë pretendim kërkuari e ka paraqitur në gjykimin në apel, pasi në këtë gjykim u pranuan si prova aktet që lidhen me sekuestrimin e pasurive gjykim i gjykuar nga gjyqtari F. P. Edhe gjyqtari A. L. është në të njëjtat pozita si gjyqtari F. P., pasi ai ka gjykuar në apel çështjen që ka të bëjë me sekuestron e pasurisë më lart duke lënë në fuqi vendimin e gjyqtarit F. P.

4.2 Gjykatat e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit për Krime të Rënda i janë referuar dëshmisë së dhënë nga dëshmitari M.H., dëshmitar, i cili nuk ka detyrimin për të dëshmuar, pasi ai është kushëri i afërt i njërit prej të bashkëpandehurve. Kjo bie në kundërshtim me nenin 158 shkronja "a" të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Prandaj dëshmia e M.H. është e pavlefshme dhe për rrjedhojë nuk mund të shërbente si provë për të arsyetuar vendimet e dhëna nga dy gjykatat ndaj kërkuarit.

4.3 Është cenuar parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër. Me vendimin penal nr.289, datë 21.12.2001, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur pushimin e gjykimit për akuzën e krijimit dhe pjesëmarrjen e kërkuesit në një bandë të armatosur, pasi nuk vërtetohet fajësia. Ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004 dhe me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007 pothuaj nuk e prekin fare përkufizimin lidhur me bandën e armatosur dhe organizatën kriminale (neni 28).

4.4 Fillimi i çështjes ndaj kërkuesit është bërë në kundërshtim me dispozitat e KPP-së dhe hetimi ndaj tij ka vazhduar përtej afateve maksimale (2-vjeçar) të parashikuara në nenin 324 të KPP-së. Edhe Gjykata e Strasburgut e ka pranuar se procesi i rregullt ligjor dhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm shtrihet edhe gjatë fazës së hetimeve paraprake.

4.5 Gjykatat kanë gabuar që e kanë gjetur fajtor kërkuesin për veprën penale të dhunimit të varreve, pasi kjo vepër është parashkruar. Kjo vepër ka ndodhur në vitin 1998. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, megjithëse ka vendosur pushimin e çështjes për kërkuesin, duke pranuar pretendimin për parashkrimin e ndjekjes penale për veprën penale të dhunimit të varreve, nuk ka pushuar ndjekjen penale për akuzat e tjera, të cilat ishin pasojë e ndjekjes penale për veprën e dhunimit të varreve.

## II

### **A. Për legjitimitimin e kërkuesit**

5. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi pretendimet e tij përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës. Gjithashtu, ai legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2 e ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata konstaton se vetëm për dy pretendime, konkretisht pretendimi për cenim të paanshmërisë së gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit për Krime të Rënda; dhe pretendimi për cenim të parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër, kërkuesi ka paraqitur argumente kushtetuese lidhur me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Pretendimet e tjera janë haptazi të pambështetura.

## III

### **B. Për pretendimin për cenim të parimit të paanshmërisë së gjykatave në procesin ndaj kërkuesit**

6. Kërkuesi pretendon se gjyqtarët F.P. dhe A. L. kanë qenë në kushte papajtueshmërie për të gjykuar përkatësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda për shkak se kanë gjykuar një proces tjetër me objekt sekuestrimin e pasurive të vëna në kuadër të organizatës kriminale të A. B. Kërkuesi është deklaruar fajtor si pjesëmarrës dhe anëtar i kësaj organizate. Ndërsa pretendimi tjetër lidhet me pjesëmarrjen në gjykim të gjyqtarës S. D., e cila, sipas kërkuesit, ka qenë në kushte papajtueshmërie për shkak se ka gjykuar më parë një çështje që lidhet me anëtarë të tjerë të së njëjtës organizatë kriminale, arsye për të cilat gjyqtarët M. B. dhe Dh. L. hoqën dorë nga gjykimi ndaj kërkuesit. Pra, sipas kërkuesit, e drejta e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor është cenuar për shkak të cenimit të parimit të paanshmërisë së gjykatës.

7. Gjykata ka sqaruar në disa raste kuptimin e standardit kushtetues të paanshmërisë së gjykatës, sipas parashikimit të nenit 42, paragrafi 2 të Kushtetutës. Ky nen shprehet se: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ... ka të drejtën e një gjykimi të drejtë ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*Shih vendimet nr.4, datë. 25.2.2009; nr.23, datë 23.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se parimi i

paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar (*Shih vendimin nr.12, datë 13.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Paragjykimi i mundshëm për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*Shih vendimin nr.4, datë 25.2.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata vëren se edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka evidentuar standarde të ngjashme për paanshmërinë e gjyqtarit/gjykatës në përputhje me garancitë e nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Sipas GJEDNJ-së, ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e nenit 6/1 duhet të përcaktohet sipas një testi subjektiv, që do të thotë në bazë të bindjes së brendshme të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe sipas një testi objektiv, që do të thotë të vlerësohet nëse gjyqtari ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me anshmërinë e tij/saj (*shih çështjen Fey kundër Austrisë, 24 shkurt 1993*).

9. Lidhur me testin subjektiv, paanshmëria personale e gjyqtarit duhet të prezumohet deri sa të provohet e kundërta (*shih edhe Hauschildt kundër Danimarkës, 24 maj 1989, § 47, Series A no. 154*). Thjesht fakti që një gjyqtar ka prapësuar të gjitha ose shumicën e pretendimeve të një kërkuesi nuk përbën një provë të tillë (*shih Fatullayev kundër Azerbaixhanit, 22 prill 2010*).

10. Sipas testit objektiv, duhet përcaktuar nëse, pavarësisht sjelljes personale të gjyqtarit, ka fakte të vërtetueshme, të cilat mund të ngrenë dyshime lidhur me paanshmërinë e tij/saj. Në këtë drejtim edhe dukja mund të ketë një farë rëndësie. Ajo që është e rëndësishme është besimi që publiku, dhe mbi të gjitha i akuzuari, duhet të kenë te gjykatat në një shoqëri demokratike. Kjo nënkupton që në vendimmarrje, nëse ka një arsye legjitime se një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i të akuzuarit është i rëndësishëm, por nuk është vendimtar. Ajo që është vendimtare është nëse kjo frikë mund të konsiderohet se është objektivisht e justifikueshme (*shih çështjen Fey, § 30; çështjen Fatullayev, supra*).

11. Në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se për pjesëmarrjen e gjyqtarëve F. P. dhe A. L., i vetmi argument që jep kërkuesi në cenim të parimit të paanshmërisë është pjesëmarrja në gjykim e këtyre dy gjyqtarëve, përkatësisht në shkallë të parë dhe në apel, në procesin me objekt sekuestrimin e pasurive të organizatës kriminale, ku është gjetur se bën pjesë me vendim penal të formës së prerë edhe kërkuesi. Për këtë argument, GJEDNJ-ja vlerëson se natyra e përgjegjësisë sipas legjislacionit civil është e ndryshme nga ajo e legjislacionit penal, pasi standarde të ndryshme të të provuarit zbatohen në çështje civile dhe penale; se një dënim penal nuk përjashton gjetjen e një përgjegjësie civile që lind nga të njëjtat fakte dhe se në të kundërt, ekzistenca e përgjegjësisë civile nuk sjell nevojshmërisht një vendim fajësie sipas ligjit penal, në lidhje me të njëjtat veprime të të pandehurit. Një situatë në të cilën i njëjti gjyqtar shqyrton si çështjen e përgjegjësisë civile, edhe të asaj penale të lindura nga të njëjtat fakte, nuk prek domosdoshmërisht paanshmërinë e gjyqtarit. Megjithatë, nëse frika e të akuzuarit për mungesën e paanshmërisë së gjyqtarit mund të konsiderohet si objektivisht e justifikueshme, kjo varet nga tiparet e veçanta të secilit rast. Thjesht fakti që një gjyqtar është përfshirë edhe në vendimet që lidhen me paraburgimin (masat e sigurisë) për çështjen, nuk mund të justifikojë në vetvete frikën për paanshmërinë e tij/saj (*shih çështjen Hauschildt kundër Danimarkës, 24 maj 1989, p. 22, 49 § 50*). Vetëm rrethanat e veçanta mund të çojnë në një përfundim tjetër. Në këtë drejtim, kanë rëndësi shtrirja dhe natyra e masave të sigurisë që ka marrë gjyqtari (*shih çështjen Fey p.12 § 30; çështjen Ekeberg dhe të tjerë kundër Norvegjisë, 31 korrik 2007*). Pyetjet që një gjyqtar duhet t'i përgjigjet kur merr vendime që lidhen me masën e sigurisë nuk janë të njëjta me ato që janë vendimtare kur merret vendimi përfundimtar i fajësisë. Dyshimi



dhe fajësia nuk trajtohen sikur të jenë e njëjta gjë (*shih p.sh., çështjen Lutz të 25 gushtit 1987, p. 62; çështjen Hauschildt*).

12. Gjykata, bazuar në standardet e mësipërme, çmon se gjyqtarët F.P. dhe A.L. e kanë gjykuar çështjen e sekuestrimit të pasurisë së organizatës së A. B. në kuadrin e një procedimi parandalues lidhur me pasurinë, sipas ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, bazuar në dyshimin dhe prezumimin për zotërimin e prejardhjen e paligjshme të pasurisë për shkak e në lidhje me këtë veprimtari kriminale. Përveç kësaj, kërkuesi nuk paraqet në kërkesë asnjë argument për rrethana objektive dhe subjektive, të cilat do të çonin në anësinë e dy gjyqtarëve në fjalë lidhur me vlerësimin e veprave penale për të cilat është gjykuar kërkuesi. Për më tepër, siç rezulton edhe nga vendimet përkatëse gjyqësore për sekuestrimin e pasurisë, gjyqtarët F. P. dhe A. L. nuk shprehen në asnjë moment për ndonjë fakt që lidhet me kërkuesin dhe vlerësimin e veprimeve ose mosveprimeve në kundërshtim me ligjin për masat parandaluese, të marra ndaj pasurisë së organizatës kriminale.

13. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë për shkak të pjesëmarrjes se gjyqtarët F. P. dhe A. L. përkatësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, si dhe në gjykimet me objekt sekuestrimin e pasurive të vëna në kuadër të organizatës kriminale të A. B. është i pambështetur.

14. Lidhur me argumentin e dytë për cenimin e parimit të paanshmërisë, Gjykata vëren se gjyqtarja S. D. ka gjykuar si anëtare e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda disa anëtarë të organizatës kriminale në fjalë, dhe ka marrë vendimin nr.20, datë 5.4.2007. Ky vendim paraqitet si shkak objektiv nga kërkuesi për të provuar anësinë e gjyqtarës në fjalë në procesin ndaj tij.

15. Gjykata vlerëson se duhet përcaktuar nëse, pavarësisht sjelljes personale të gjyqtarës S.D., ka fakte të vërtetueshme, të cilat mund të ngrenë dyshime lidhur me paanshmërinë e saj. Gjithashtu, Gjykata nisat nga premisa se, nëse ka një arsye legjitime që një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i të akuzuarit është i rëndësishëm, por nuk është vendimtar. Ajo që është vendimtare është nëse kjo frikë mund të konsiderohet se është objektivisht e justifikueshme.

16. Nga vendimi nr.20, datë 5.4.2007, gjyqtarja, si anëtare e trupit gjykues nuk shpreh asnjë vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e fakteve e rrethanave që lidhen me pjesëmarrjen e kërkuesit në organizatën kriminale, ku u gjetën si pjesëmarrës të gjykuarit në procesin penal që lidhet me këtë vendim të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda (vendimi nr.20). Vlerësimi i akuzës ndaj kërkuesit është bërë në procesin penal kundër tij me vendimet objekt shqyrtimi kushtetues të Gjykatave të Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe të Apelit për Krime të Rënda. Gjykata e Apelit i referohet vendimit nr.20 datë 5.4.2007 si vendim që ka marrë formë të prerë në kontekstin e nenit 193/5 të KPP-së duke e vlerësuar këtë vendim si provë për ekzistencën e bashkëpunimit në formën më të lartë të tij, në atë të organizatës kriminale, mes të bashkëpandehurve D. V., E. C., M.C. e P. L. për veprat penale për të cilat ata janë gjykuar. Por ky vendim gjyqësor nuk shprehet për veprën e penale të vënies zjarr të banesës së SH. H. Në vendimin nr.20, datë 5.4.2007 dhe procesin për arritjen e tij, sa i takon pjesëmarrjes në të njëjtën organizatë kriminale të kërkuesit, gjyqtarja apo trupi gjykues nuk disponon në asnjë vend apo rresht për fakte apo rrethana që lidhen me kërkuesin Enver Boriçi, si pjesëmarrës në këtë organizatë. Vlerësimi i veprimtarisë penale dhe i akuzave në ngarkim të kërkuesit janë bërë vetëm në procesin kundër tij dhe vendimeve objekt shqyrtimi.

17. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë për shkak të pjesëmarrjes në gjykim të gjyqtarës S. D., e cila sipas kërkuesit, ka qenë në kushte papajtueshmërie për shkak se ka gjykuar më parë një çështje që lidhet me anëtarë të tjerë të së njëjtës organizatë kriminale, është i pambështetur.

#### ***C. Për pretendimin për shkelje të parimit 'ne bis in idem'***

18. Kërkuesi pretendon se është cenuar parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën veprë. Me vendimin penal nr.289, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Apelit Durrës, për kërkuesin vendoset pushimi i gjykimit për akuzën e krijimit dhe pjesëmarrjen në një bandë të armatosur pasi nuk

vërtetohet fajësia. Sipas kërkesit, ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004 dhe me ligjin nr.9686 datë 26.2.2007 pothuaj nuk e prekin fare përkufizimin lidhur me bandën e armatosur dhe organizatën kriminale (neni 28), pasi janë e njëjta gjë.

19. Gjykata është shprehur se parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën veprë (*ne bis in idem*) është njohur si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta dhe një nga instrumentet kryesore juridike të brendshme e ndërkombëtare, që rregullojnë marrëdhëniet në fushën penale, si dhe përgjegjësinë për kundërvajtje. Sipas këtij parimi, askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një veprë penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar (*shih vendimin nr.10, datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron tek zbatimi dy a më shumë herë i të njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtën veprë penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj (vendimi nr.5, datë 8.3.2005 i Gjykatës Kushtetuese). Kriteri “e njëjta veprë” i referohet të njëjtut veprim, sjellje, fakt, veprë penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj veprë dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm (*vendimi nr.5, datë 8.3.2005 i Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në çështjen në shqyrtim, me vendimet objekt kontrolli kushtetues, kërkuesi është gjetur fajtor nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, ndër të tjera për veprën penale të pjesëmarrjes në organizatë kriminale, dhe jo në bandë të armatosur, sipas parashikimeve të nenit 333/2 dhe 334 të Kodit Penal (KP). Gjykata vëren se me vendimin nr.289 datë 21.12.2001, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur pushimin e gjykimit për të kërkuenin Enver Boriçi për akuzën e krijimit dhe pjesëmarrjes në bandë të armatosur parashikuar nga neni 333 i KP-së pasi nuk provohet fajësia. Çështja që shtrohet nga kërkuesi është nëse vepra penale “pjesëmarrja në bandë kriminale” dhe “pjesëmarrja në organizatë kriminale” janë e njëjta veprë apo janë vepra të ndryshme.

21. Gjykata vëren se në kohën kur është gjykuar kërkuesi për akuzën e pjesëmarrjes në bandë të armatosur, KP-ja bënte dallim ndërmjet pjesëmarrjes në bandë të armatosur dhe në organizatë kriminale. Neni 28 i KP-së të mëparshëm i zbatuar nga Gjykata e Apelit Durrës parashikonte se “banda e armatosur dhe organizata kriminale përfaqësojnë forma të bashkëpunimit të veçantë, të cilat dallojnë nga njëra-tjetra jo vetëm nga numri i pjesëmarrësve, por edhe nga shkalla e organizimit dhe e qëndrueshmërisë së tyre për kryerjen e një numri veprash penale”. Ligji nr.9275, datë 16.9.2004 e ndryshoi nenin 28 duke bërë përsëri dallimin ndërmjet organizatës kriminale dhe bandës kriminale, por duke qartësuar dallimet ndërmjet këtyre formave të bashkëpunimit kriminal. Kështu, sipas nenit 28 të ndryshuar, “Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale (neni 28/1). Ndërsa banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi që, duke zotëruar armë, municione luftarake dhe mjete të tjera të nevojshme, synon kryerjen e veprave penale, të parashikuara në krerët V, VI, e VII të këtij kodi (neni 28/3). Neni 333 i pjesës së posaçme të KP-së i referohet pjesëmarrjes në organizatë kriminale. Në bazë të këtij neni është dënuar edhe kërkuesi. Pra, ndryshe nga sa shprehet kërkuesi në kërkesë, pjesëmarrja në organizatë kriminale dhe pjesëmarrja në bandë kriminale janë vepra të ndryshme penale.

22. Në vijim të gjithë këtyre parashikimeve të KP-së, Gjykata çmon se parimi *ne bis in idem* nuk është shkelur, pasi edhe nëse vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës do të lexohej si vendim pafajësie për pjesëmarrje në bandë të armatosur, vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (vendimi i formës së prerë) lidhet me një veprë tjetër penale, që është pjesëmarrja në një organizatë kriminale, dallim i qartësuar nga neni 28 i Kodit Penal.

23. Për këto arsye, Gjykata çmon se edhe pretendimi i kërkesit për cenimin e parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën veprë është i pambështetur.

## PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

## VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.  
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Petrit Ploçi, Sokol Sadushi, Admir Thanza, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj  
Anëtar pjesërisht kundër: Vladimir Kristo

## VENDIM

**Nr.34, datë 25.7.2011**

## NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datat 10.3.2011 dhe 14.4.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 4 Akti që i përket:

**KËRKUES:** Shefit Kadriu

**SUBJEKT I INTERESUAR:** 1. CEZ SHPËRNDARJE, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.751, datë 10.4.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimi i çështjes për rigjykim.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, kërkuesin që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

I

Me vendimin nr.6, datë 5.3.2007 të Drejtorit të Divizionit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Zona e Burrelit, të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare është bërë shkëputja e marrëdhënieve të punës ndërmjet kërkuesit dhe ndërmarrjes së sipërpërmendur.

Kërkuesi ka ankimuar vendimin e sipërpërmendur të pushimit të Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Dibrës, e cila me vendimin nr.225, datë 2.5.2007 ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

Vendimin e mësipërm, të gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi e ka ankimuar pranë Gjykatës së Apelit të Tiranës, e cila me vendimin nr.751, datë 10.4.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.225, datë 2.5.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Dibrës.

Kërkuesi ka ushtruar rekurs të Gjykata e Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimit nr.751, datë 10.4.2008 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe pranimin e kërkesëpadisë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2010-85, datë 11.2.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit në Dhomë Këshillimi.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, për arsye se, nga ana e Gjykatës së Apelit të Tiranës, i është mohuar e drejta për të marrë pjesë në gjykim, e sanksionuar nga neni 42/2 i Kushtetutës. Sipas tij, Gjykata e Apelit të Tiranës, në kundërshtim me detyrimet që burojnë nga neni 460 i Kodit të Procedurës Civile, nuk ka bërë njoftimin për ditën dhe orën e gjykimit me shpallje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Dibrës dhe, për rrjedhojë, nuk ka marrë dijeni për zhvillimin e gjykimit. Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë plenare kërkuesi i shtoi objektin të kërkesës edhe shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2010-85, datë 11.2.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur prej tij.

Kërkuesi legjitimohet *ratione materiae* për arsye se, në përputhje me nenet 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, Gjykata shqyrton kërkesat e individëve për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Kërkuesi legjitimohet, gjithashtu, *ratione temporis* për arsye se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Gjykata vendosi të thërrasë me cilësinë e subjektit të interesuar “CEZ Shpërndarje” meqenëse pas kontratës së lidhur me Këshillin e Ministrave, më datë 11 mars 2009, kësaj kompanie (e quajtur fillimisht “CEZ Group” dhe duke filluar nga datë 1.10.2010 “CEZ Shpërndarje”) i kanë kaluar kompetencat që kishte më parë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare”, në vartësi të së cilës ishte Divizioni i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, zona e Burrelit.

## II

*Për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim dhe parimit të kontradiktoritetit të garantuar nga neni 42/2 i Kushtetutës*

Gjykata, në jurisprudencën e saj konstante, ka përcaktuar disa standarde kushtetuese të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t’u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë, në raport me palën kundërshtare.

E drejta për t’u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, i paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat e sipërpërmendura, të cilat i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor.

Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se “Rekursi që ushtrohet ndaj vendimit të gjykatës së apelit, i duhet njoftuar palës së interesuar, për t’i dhënë asaj mundësi për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë dhe për t’u mbrojtur”. Në rastin në shqyrtim, moskomunikimi i rekursit i ka mohuar kërkuesit të drejtën e pjesëmarrjes në gjykim në gjykatë dhe të mbrojtjes, çka e bëri procesin të parregullt në kuptimin kushtetues. Privimi i palës në proces nga mundësia, që nëpërmjet përfaqësimit të mbrojtë interesat e veta në gjykim, është konsideruar shkelje

e standardeve të procesit të rregullt në shumë vendime të Gjykatës Kushtetuese” (shih vendimin nr.34 datë 03.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’i garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por përkundrazi duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t’u japin mundësi të barabarta palëve, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre.

Në këtë aspekt, një rol të veçantë ka luajtur edhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, e cila e ka ngritur parimin e kontradiktoritetit në nivelin e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, duke e konsideruar si një element të domosdoshëm të një gjykimi të drejtë (shih *Vermeulen k. Belgjikës*, vendimi i datës 20 shkurt 1996 § 33, *Nideröst-Huber k. Zvicrës*, vendimi i datës 18 shkurt 1997, § 24).

Gjykata, në jurisprudencën e saj, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit, ndonëse nuk gjendet i shprehur në mënyrë eksplicite në normat kushtetuese. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin civil, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor.

Për sa më sipër, duke qenë se për parimin e barazisë së armëve ka një jurisprudencë konstante dhe të konsoliduar të Gjykatës, nuk mund të vihet më në dyshim se ky parim është tashmë një garanci kushtetuese e cila shfaqet si pjesë integrale e garancisë për një proces të rregullt ligjor. (shih vendimet: nr.5, datë 17.2.2003; nr.33, datë 24.11.2003; nr.16, datë 8.6.2006; nr.13, datë 21.7.2008; nr.28, datë 2.10.2009; nr.30, datë 26.11.2009; nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

Parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në gjykim, është një parim i cili është pjesë e domosdoshme qoftë e procesit penal, ashtu edhe civil. Për sa më sipër, edhe pse parimi i kontradiktoritetit mund të zhvillohet më shumë nga doktrina dhe jurisprudenca në fushën penale, ku ky i fundit është pjesë e të drejtës së mbrojtjes të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës, është përsëri i zbatueshëm në procesin civil, pasi ky proces duhet të garantojë barazi substanciale të palëve dhe është e padiskutueshme që kontradiktoriteti efektiv midis palëve e arrin këtë qëllim.

Kështu, Gjykata ka theksuar se “Në shqyrtimin e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese përqendrohet vetëm në ato pretendime që kanë të bëjnë me parimet themelore të procesit gjyqësor civil. Në këtë kuadër ka rëndësi të shqyrtohet pretendimi për shkeljen e parimit të barazisë së armëve në proces, si dhe pretendimi për shkeljen e parimit të sigurisë juridike si një aspekt i parimit të shtetit të së drejtës.

Me këtë rast Gjykata thekson se barazia e armëve është një aspekt i rëndësishëm i konceptit të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Ky parim nënkupton që secilës palë në proces t’i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet (ku përfshihet edhe paraqitja e provave nga ana e saj), në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të dukshëm në raport me palën tjetër.” (shih vendimin nr.23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese ).

Siç rezulton nga dosja gjyqësore, zhvillimi i Gjykimit në Gjykatën e Apelit të Tiranës është zhvilluar pa praninë e palëve. Neni 460 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se njoftimi i gjykimit bëhet me shpallje te gjykata e apelit që ka në shqyrtim çështjen dhe te gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin e ankimuar. Nga vërtetimi i dërguar nga kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Dibrës, si dhe nga materialet e administruara në seancë, u provua se njoftimi për datën dhe orën e gjykimit, në kundërshtim me dispozitën procedurale si më lart, nuk është shpallur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Dibrës, ku ka vendbanimin kërkuesi.

Gjykata vlerëson se ishte detyrë e Gjykatës së Apelit të Tiranës të verifikonte nëse njoftimi i palëve ishte bërë në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me nenin 460 të Kodit të Procedurës Civile, çka ajo nuk e ka bërë.

Gjykata vëren, gjithashtu, se ndonëse pretendimi si më sipër është ngritur nga kërkuesi edhe në rekursin e tij dërguar Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ky i fundit, në vendimin nr.00-2010-85, datë 11.2.2010 jo vetëm nuk e ka vlerësuar, por as është shprehur për të, duke vendosur mospranimin e rekursit në Dhomë Këshillimi.

Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mohimit të së drejtës së tij për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes, objekt shqyrtimi, në Gjykatën e Apelit të Tiranës, për shkak të mosnjoftimit të datës dhe orës së gjykimit, janë të bazuara.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134 shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.751, datë 10.4.2008 të Gjykatës së Apelit të Tiranës.
- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2010-85, datë 11.2.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Tiranës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Ploçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 8.8.2011  
Doli nga shtypi më 9.8.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë